REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËS, ÇËSHTJEVE SOCIALE
DHE SHANSEVE TË BARABARTA

# PLANI I VEPRIMIT PËR FËMIJË

# 2012 - 2015

# PLANI I VEPRIMIT PËR FËMIJË

## 2012 - 2015

# Parathënie

Respektimi i të drejtave të fëmijëve është detyra e të gjithëve, si familjarë, qytetarë dhe anëtarë të një komuniteti.

Plani i Veprimit për Fëmijë 2012 - 2015, është një dokument që synon të nxisë bashkëpunimin ndërmjet aktorëve të ndryshëm qeveritarë, donatorëve, shoqërisë civile dhe komunitetit, për të marrë vendime të orientuara drejt respektimit të të drejtave të fëmijëve.

Miratimi i këtij dokumenti politik, në të njëjtën kohë, përmbushi edhe një nga pikat e rekomandimit 11 të BE-së për integrimin europian të vendit tonë.

Realizimi i të drejtave të fëmijëve për mbrojtje dhe përfshirje sociale; për mbrojtjen nga dhuna, abuzimi; për arsimim cilësor; për kujdes shëndetësor; për mbrojtje ligjore, do të mbeten përsëri prioritetet tona, duke siguruar kështu vazhdueshmërinë e politikave sociale të ndërmarra.

Plani i Veprimit për Fëmijë 2012 - 2015, pasqyron në të njëjtën kohë edhe ndryshimet e rëndësishme legjislative dhe institucionale që kanë ndodhur vitin e fundit. Një ligj i ri për të drejtat e fëmijëve dhe krijimi i mekanizmave të reja për realizimin e këtyre të drejtave, kanë krijuar një realitet të ri që kërkon marrjen e përgjegjësive të qarta sidomos nga pushteti vendor.

Shpresoj që zbatimi i këtij Plani Veprimi, të nxisë dhe forcojë bashkëpunimin ndërmjet të gjithë aktorëve në këtë fushë, për të arritur një qëllim të përbashkët "një mjedis të sigurtë për fëmijët tanë".

**SPIRO KSERA**

**Ministër i Punës Çështjeve Sociale**
**dhe Shanseve të Barabarta**

# Lista e Shkurtimeve

| | |
|---|---|
| ASHMDF | Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve |
| AKSHI | Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit |
| BE | Bashkimi Europian |
| DAR | Drejtoritë Rajonale Arsimore |
| DPGJC | Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile |
| COMBI | Për një shkollë miqësore pro sjelljeve pozitive |
| KM | Këshilli i Ministrave |
| KMD | Komisioneri për Mbrojtje nga Diskriminimi |
| KDF | Konventa për të Drejtat e Fëmijëve |
| KKMDF | Këshilli Kombëtar për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve |
| KSHP | Kujdesi Shëndetësor Parësor |
| KSHB | Komiteti Shqiptar i Birësimit |
| KP | Kodi Penal |
| KPP | Kodi i Procedurës Penale |
| IEVP | Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale |
| IST | Infeksionet Seksualisht të Transmetueshme |
| ISHP | Inspektoriati Shtetëror i Punës |
| ISHP | Instituti i Shëndetit Publik |
| ISSH | Instituti i Sigurimeve Shëndetësore |
| MB | Ministria e Brendshme |
| MITIK | Ministria për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit |
| MD | Ministria e Drejtësisë |
| MRD | Mënyrat e Reja të Disiplinimit |
| MSH | Ministria e Shëndetsisë |
| MASH | Ministria e Arsimit dhe Shkencës |
| MPÇSHSB | Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Mundësive të Barabarta |
| NE | Ndihmë Ekonomike |
| NJDF | Njësia për të Drejtat e Fëmijëve |
| NJMF | Njësia e Mbrojtjes së Fëmijëve |
| NJQV | Njësitë e Qeverisjes Vendore |
| OBSH | Organizata Botërore e Shëndetit |
| OJF | Organizatat Jo Fitimprurëse |
| QN | Qeveritë e Nxënësve |
| SHSSH | Shërbimi Social Shtetëror |
| VMNJ | Vlerësimi mbi Matjen e Nivelit të Jetesës |
| VKM | Vendim i Këshillit të Ministrave |
| ZABGJ | Zyra e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor |
| UNICEF | Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët |

# Falenderime

Procesi i hartimit të Planit të Veprimit për Fëmijë 2012-2015, ishte një proçes ndërveprues dhe gjithë-përfshirës, i udhëhequr nga MPÇSSHB, e cila angazhoi institucione të qeverisjes qendrore, lokale, shoqërisë civile, organizatave jofitimprurëse, si dhe donatorë e partnerë ndërkombëtarë.

Për përgatitjen e Planit të Veprimit për Fëmijë 2012-2015, kontribuan Znj. Miranda Pashaj dhe Znj. Arda Lazareni nga Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve, përfaqësues të ministrisë MPÇSSHB, MSH, MASH dhe institucione të tjera si Avokati i Popullit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Komiteti Shqiptar i Birësimeve, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, Shërbimi Social Shtetëror, Inspektoriati Shetëror i Punës, Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor, Instituti i Shëndetit Publik.

Falenderime të veçanta i shkojnë Znj. Ilda Melo, Znj. Jolanda Memaj, Z. Dritan Sulçebe dhe Znj. Alba Braço, të cilët në cilësinë e ekspertëve, ndihmuan në mbledhjen dhe përpunimin e informacionit, realizuan takimet me përfaqësuesit e institucioneve shtetërore si edhe ndihmuan në përgatitjen e dokumentit.

Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta falenderon organizatat e shoqërisë civile për komentet e vlefshme të paraqitura gjatë diskutimit të Planit të Veprimit për Fëmijë dhe që ndikuan në përmirësimin cilësor të tij dhe UNICEF për mbështetjen në gjithë këtë proces.

Plani Kombëtar i Veprimit për Fëmijë u përkthye në gjuhën angleze nga Mimoza Gjika.

# Përmbajtja

**Parathënie** ........ **3**

**Lista e Shkurtimeve** ........ **4**

**Falenderime** ........ **5**

**Hyrje** ........ **7**

**Kapitulli 1** ........ **9**
*Kuadri ligjor dhe mekanizmat institucionalë për zbatimin e politikave që mbrojnë të drejtat e fëmijëve*

**Kapitulli 2** ........ **11**
*E drejta për mbrojtje dhe përfshirje sociale*

**Kapitulli 3** ........ **13**
*E drejta e fëmijëve për mbrojtje nga dhuna, abuzimi dhe shfrytëzimi ekonomik*

**Kapitulli 4** ........ **15**
*E drejta për zhvillim dhe arsim*

**Kapitulli 5** ........ **17**
*E drejta për kujdes shëndetësor*

**Kapitulli 6** ........ **19**
*E drejta për mbrojtje ligjore*

**Vlerësime përfundimtare** ........ **21**
*Probleme kritike në lidhje me zbatimin e Planit të Veprimit*

**Plani i masave për zbatimin e objektivave strategjike, 2012-2015** ........ **23**

# Hyrje

Në programin e Qeverisë së Shqipërisë 2009-2013, nënvizohet angazhimi për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve: "... gjatë këtij mandati, ne zotohemi të përmirësojmë me shpejtësi treguesit bazë të shëndetit të fëmijës duke i sjellë ato në nivelet europianë, do të shtrijmë vaksinimin ndaj të gjitha sëmundjeve të rrezikshme për shëndetin e fëmijëve, të ngremë në të katër anët e vendit sistemin e arsimit parashkollor, si kusht për një parapërgatitje dinjitoze të fëmijëve tanë në shkolla".[1]

Në këtë program, objektivat e të drejtave të fëmijëve konsiderohen si një nga objektivat e rëndësisë së veçantë, gjë e cila është shprehur me thellimin e reformës legjislative dhe institucionale, për të krijuar një mjedis mbrojtës dhe gjithëpërfshirës për fëmijët. Kjo reformë ka kulmuar me miratimin e Ligjit nr. 10347, datë 4.11.2010, "Për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës", si edhe me krijimin e Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve.

Politikat për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve janë pjesë e rëndësishme e Strategjisë Kombëtare për Zhvillimin dhe Integrimin 2007 – 2013 (SKZHI), në të cilën kristalizohet vizioni afatmesëm dhe afatgjatë i zhvillimit të vendit bazuar në një proces të hapur dhe transparent. Në këtë dokument, çështjet që lidhen me të drejtat e fëmijës trajtohen në seksionin: Zhvillimi Social dhe Ekonomik[2]. Strategjia harton objektiva për zbutjen e varfërisë, luftën kundër trafikimit dhe formave më të këqija të punës së fëmijës, forcimin e arsimit të detyrueshëm dhe ngritjen e nivelit të shërbimit shëndetësor për fëmijët. Në mënyrë eksplicite, në dokument citohet i domosdoshëm zbatimi i legjislacionit për nxitjen e të drejtave të fëmijëve dhe mbrojtjen e jetës dhe shëndetit, si dhe garantimin e arsimimit dhe zhvillimin.

Strategjia Ndërsektoriale e Përfshirjes Sociale 2007-2013, e miratuar me VKM Nr. 218, datë 3.02.2008, trajton në një dimension gjithëpërfshirës çështjet dhe grupet e synuara që shtrihen përtej thelbit të problemeve afatgjata strukturore të zhvillimit, me të cilat përballet Shqipëria. Strategjia i kushton vëmëndje të posaçme vlerësimit të progresit të politikave të reduktimit të varfërisë si edhe të ndikimit që këto politika kanë në realizimin e të drejtave të fëmijëve. Gjithashtu, në mbështetje të zbatimit të parimit të mundësive të barabarta, në të përfshihen dinamikat e zhvillimit të individëve në nevojë, familjeve dhe grupeve në komunitet që nga periudha e miratimit të kësaj strategjie.

Përveç strategjive të mësipërme, të cilat shërbejnë si udhërrëfyes për hartimin e politikave sektoriale dhe ndërsektoriale për të drejtat e fëmijëve, parimet, objektivat, ndërhyrjet afatgjata dhe afatshkutëra me përfitues të drejtëpërdrejtë fëmijët, parashikohen në strategji të veçana për fëmijët (2000-2005 dhe 2005-2010).

Strategjia Kombëtare dhe Plani i Veprimit për Fëmijët 2005 – 2010 si edhe raportet periodike vjetore të progresit të kësaj strategjie nënvizojnë në mënyrë sistematike domosdoshmërinë e koordinimit dhe harmonizimit të politikave ndërsektoriale me qëllim rritjen e efektivitetit të tyre në funksion të një garantimi të plotë të të drejtave të fëmijëve. Strategjia dhe Plani i veprimit për Fëmijë, 2005-2010 përfaqësojnë një hap progresiv të fuqishëm për Shqipërinë në raport me të drejtat e fëmijëve, sepse në harkun kohor të 5 vjetëve:

1. Të drejtat e fëmijëve u bënë pjesë e një programi politik kompleks, në të cilin komponentët ligjorë, institucionalë, financiarë dhe vlerësues të ecurisë, janë të gërshetuar në mënyrë harmonike.
2. Politikat për realizimin e të drejtave të fëmijëve dhe ndikimi i tyre në përmirësimin e mirëqënies së fëmijëve janë pjesë e debatit politik si edhe e çdo raportimi kombëtar;
3. Çështjet e të drejtave të fëmijëve janë pjesë e bashkëpunimit ndërinstitucional në nivel qendror dhe në nivel vendor. Në disa rajone të vendit, këto bashkëpunime janë materializuar nëpërmjet strategjive rajonale dhe planeve të veprimit për fëmijë;
4. Çështjet e të drejtave të fëmijëve po shndërrohen në çështje të të gjithë shoqërisë, duke siguruar përfshirjen dhe angazhimin e shumë aktorëve, qeveritarë dhe të shoqërisë civile si edhe të vetë fëmijëve.
5. Ngritja fillimisht e Sekretariati Teknik për Fëmijë, strukturë brenda MPÇSSHB dhe më pas krijimi i Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve (ASHMDF), institucion ekzekutiv në varësi të MPÇSSHB, ishin hapa të rëndësishëm në

[1] Për Shqipërinë Europianë – Programi i maxhorancës dhe qeverisë së integrimit europian 2009-13, paraqitur në Kuvendin e Shqipërisë, më 16.09.2009

[2] SKZHI, 2008, f.42 dhe f 60.

krijimin e strukturës përgjegjëse për monitorimin dhe raportimin mbi zbatimin e të drejtave të fëmijëve në vend. Aktualisht ASHMDF është institucioni përgjegjës që monitoron zbatimin e ligjit, koordinon me të gjithë aktorët në nivel qendror e vendor politikat që lidhen me të drejtat e fëmijëve dhe vlerëson realizimin e tyre në Shqipëri.

Analiza e situatës ekonomike dhe sociale të vendit, tregon se edhe pse progresi është i dukshëm dhe mirëqënia është rritur, Shqipëria ende është një nga vendet më të varfëra të Europës.

Vlerësimi mbi Matjen e Nivelit të Jetesës i vitit 2008 konfirmon se përqindja e të varfërve në Shqipëri është zvogëluar nga 25.4 përqind në 2002 në 12.4 përqind në 2008. Popullsia ekstremisht e varfër, e përcaktuar si personat që kanë vështirësi në përmbushjen e nevojave bazë ushqimore, u ul nga 5 përqind në vitin 2002 në 1.2 përqind në atë 2008.

I njëjti studim pranon se varfëria vazhdon të jetë një fenomen rural edhe për shkak të mundësisë së kufizuar që popullsia rurale ka në përdorimin e shërbimeve publike. 1.8 përqind e fëmijëve jetojnë në varfëri ekstreme sipas VMNJ-së, 2008, ndërsa 17.14 përqind e fëmijëve jetojnë në varfëri. 13.48 përqind e fëmijëve të rajonëve malore jetojnë në familje në të cilat të dy mbajtësit e familjes ose vetëm njeri janë të papunë, ndërsa në nivel kombëtar ky tregues është 9.3[3] përqind.

Varfëria ndikon në rritjen e përjashtimit social dhe pabarazive rajonale. Zonat rurale dhe rajonet malore rezultojnë tejet të varfëra, sipas të gjitha përkufizimeve të varfërisë.

Nuk ekzistojnë modele qartësisht të ndara gjeografike për grupet më të rrezikuara dhe në varfëri ekonomike. Sidoqoftë, përjashtimi social është më i prekshëm dhe i qartë në zonat rurale. Një pjesë e konsiderueshme e kësaj popullsie është e përjashtuar për një arsye ose një tjetër nga mundësia e përdorimit të shërbimeve sociale dhe të punësimit, meqënëse këto shërbime janë kryesisht të disponueshme në qytete. Besohet se për shumë familje, mundësia e kufizuar e përdorimit të shërbimeve bazë, përfshirë edhe shërbimet e punësimit, është faktori kryesor që redukton aftësinë e tyre për të nxjerrë veten nga varfëria.

Megjithë sukseset e arritura, problemet që ndikojnë në mohimin e të drejtave të fëmijëve, janë komplekse. Si të tilla, ato kërkojnë edhe ndërhyrje nëpërmjet politikave komplekse dhe gjithëpërfshirëse, të cilat kanë në qendër të vëmëndjes "përfshirjen sociale të fëmijëve" në vend të përjashtimit.

Në këtë kuadër politik e shoqëror, Plani i Veprimit për Fëmijë 2012-2015 tërheq vëmëndjen në dy drejtime kryesore:

a. Forcimin e strukturave institucionale të krijuara për të monitoruar dhe raportuar mbi zbatimin e të drejtave të fëmijëve në nivel kombëtar e rajonal;

b. Nxitjen e hartimit të politikave gjithëpërshirëse, të koordinuara e harmonizuara të mbrojtjes dhe përfshirjes sociale të fëmijëve.

[3] Studimi "Reformimi i Ndihmës Ekonomike: Nga mbijetesa tek investimi në reduktimin e varfërisë", fq. 56, UNICEF

# Kapitulli I

## *Kuadri ligjor dhe mekanizmat institucionalë për zbatimin e politikave të përfshirjes sociale që mbrojnë të drejtat e fëmijëve.*

Si rezultat i një procesi diskutimi me pjesëmarrje të gjerë nga institucionet qeveritare e shoqëria civile, Kuvendi i Shqipërisë miratoi ligjin Nr.10347 datë 04.11.2010, për "Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve". Miratimi i këtij ligji shënon një arritje të rëndësishme në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve përmes një kuadri të plotë ligjor dhe institucional në përputhje me Kushtetutën Shqiptare dhe Konventën mbi të Drejtat e Fëmijës.

Ligji vendos themelin për ngritjen e mekanizmave të përshtatshëm institucionalë që do të garantojnë dhe sigurojnë respektimin e të drejtave të fëmijëve nga individët, familja, dhe shteti. Ligji siguron të gjitha masat e nevojshme për garantimin e jetës, mirërritjes dhe zhvillimit të fëmijës nëpërmjet një qasje të koordinuar ndërmjet aktorëve të ndryshëm që punojnë në fushën e të drejtave dhe të mbrojtjes së fëmijës. Pritet që ky ligj të përmirësojë ndjeshëm sistemin e mbrojtjes së fëmijës në Shqipëri duke institucionalizuar Njësitë e Mbrojtjes së të Drejtave të Fëmijës si struktura të nivelit lokal të cilat përgjigjen për koordinimin dhe vënien në zbatim të shërbimeve të mbrojtjes së fëmijës dhe menaxhimin e rasteve, në bashkëpunim me një numër aktorësh të fushave të ndryshme. Gjithashtu, në këtë ligj parashikohet si detyrim ligjor bashkëpunimi dhe bashkërendimi i punës ndërmjet institucioneve përgjegjëse në nivel qendror dhe vendor, duke e rregulluar këtë marrëdhënie nëpërmjet rregullave që do të përcaktojë Këshilli i Ministrave.

Në ligj parashikohet ngritja dhe funksionimi i **Këshillit Kombëtar për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve** (KKMDF), si një organ këshillimor panë Këshillin e Ministrave. Në përputhje me programin e qeverisë ai koordinon dhe përcakton politikat që duhen ndjekur për fëmijët dhe monitoron zbatimin e strategjisë kombëtare për të drejtat e fëmijës. Ky organ këshillimor ka në përbërje të tij 9 anëtarë, përfaqësues të ekzekutivit, të pushtetit vendor dhe të shoqërisë civile. Gjithashtu, parashikohet se pranë Këshillit do të ngrihen komitetet teknike, të cilat do të kenë funksion ndihmës për Këshillin, kryesisht në lidhje me vendimet që do të duhet të ndërmarrë ky organ.

Në ligj parashikohen edhe detyrat e **Ministrit që bashkërendon punën për çështjet e mbrojtjes së të drejtave të fëmijës**, i cili në referim të fushës së veprimtarisë që ushtrohet aktualisht, Ministri e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, do të jetë Ministri që do të mbulojë detyrat e parashikuara në nenet përkatëse.

Në zbatim të ligjit Nr 10347 "Për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve", është ngritur dhe funksionon **Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve**. Agjencia është institucion ekzekutiv, në varësi të ministrit që bashkërendon punën për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve ngritur me Urdhër të Kryeministrit Nr 30, dt 18.03.2011.

Detyrat e Agjencisë sanksionohen në ligj, ndërsa misioni i saj realizohet nëpërmjet funksioneve që vijojnë:

1. të monitorimit të zbatimit të ligjit nr. 10347, datë 04.11.2010 "Për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës" dhe legjislacionit në fuqi, si dhe të koordinimit të autoriteteve shtetërore përgjegjëse për monitorimin e zbatimit të strategjive dhe politikave në fushën e të drejtave të fëmijëve;
2. të propozimit në ministrinë që bashkërendon çështjet për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, për ndërhyrje në politika dhe legjislacion, bazuar në problematikat që kanë dalë gjatë monitorimit të zbatimit të ligjit, strategjive dhe politikave në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijës;
3. të propozimit për udhëzime metodologjike për njësitë e të drejtave dhe të mbrojtjes së fëmijës në organet e qeverisjes vendore;
4. të mbështetjes teknike, për strukturat e organeve të qeverisjes qendrore dhe vendore, si dhe për organizatat jofitimprurëse, që punojnë në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijës;
5. të koordinimit me të gjitha strukturat e qeverisjes qendrore dhe vendore për përgatitjen e raporteve, informacionëve dhe statistikave për gjendjen e zbatimit të të drejtave të fëmijëve në Shqipëri;
6. të ndëshkimit ndaj subjektëve të cilat shkelin dispozitat e ligjit nr. 10347, datë 04.11.2010, "Për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës."

ASHMDF ndjek zbatimin e këtij plan veprimi nga institucionet përgjegjëse në nivel qëndror dhe vendor, harton raportet e progresit, orienton dhe mbështet

donatorët vendas dhe ndërkombëtarë për zbatimin e objektivave të Planit të Veprimit për Fëmijë dhe organizon studime dhe analiza mbi gjendjen e fëmijëve në Shqipëri.

Për të plotësuar kuadrin institucional, që ligji synon të krijojë me qëllim zbatimin efektiv të tij, është parashikuar ngritja e **Njësisë për të Drejtat e Fëmijës** në nivel qarku dhe **Njësisë për Mbrojtjen e Fëmijës** në nivel bashkie apo komune. Ngritja dhe funksionimi i këtyre njësive do të bëjë të mundur zbatimin dhe monitorimin e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve, duke filluar që në terren, pra nga baza e duke vazhduar vertikalisht drejt ekzekutivit. Në respektim të parimit të autonomisë lokale, ligji ka parashikuar funksionimin e këtyre njësive brenda organizimit administrativ të strukturave përkatëse të pushtetit lokal, me detyrat e parashikuara në ligj.

Ligji Nr.10347 datë 04.11.2010 sanksionon krijimin e Njësive për të Drejtat e Fëmijës në çdo qark të Shqipërisë. NjDF funksionon si pjesë e strukturës administrative të Qarkut dhe ka për detyrë:

a. të monitorojë dhe të vlerësojë mënyrën e zbatimit të ligjeve dhe të politikave që lidhen me mbrojtjen e të drejtave të fëmijës në territorin e qarkut;

b. të identifikojë dhe të koordinojë referimin e rasteve të shkeljeve apo të abuzimit, të keqpërdorimit të të drejtave të fëmijëve në territorin e qarkut;

c. të koordinojë funksionimin e grupit multidisiplinar, për identifikimin, analizën dhe referimin e rasteve të dhunës në familje në territorin e qarkut;

d. të bashkëpunojë dhe të shkëmbejë informacionin për trajtimin e të drejtave të fëmijës me çdo strukturë përgjegjëse shëndetësore, arsimore, policore, të qeverisjes vendore, në bashki dhe komuna, apo të shoqërisë civile;

e. të organizojë takime informuese, edukuese dhe trajnuese për të drejtat e fëmijës në qark;

f. t'i raportojë këshillit të qarkut për ecurinë e respektimit të të drejtave të fëmijës në territorin e qarkut;

g. t'i raportojë periodikisht Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës të dhënat statistikore që ka përpunuar, për gjendjen e të drejtave të fëmijës në qark;

h. t'i paraqesë periodikisht Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës informacione për situatën e zbatimit të të drejtave të fëmijës në qark.

Objektivat dhe masat e Planit të Veprimit për Fëmijë 2012-2015 janë grupuar sipas të drejtave të fëmijës:

1. E drejta për mbrojtje dhe përfshirje sociale
2. E drejta e fëmijëve për mbrojtje nga dhuna, abuzimi dhe shfrytëzimi ekonomik
3. E drejta për zhvillim dhe arsim
4. E drejta për kujdes shëndetësor
5. E drejta për mbrojtje ligjore

# Kapitulli 2

## *E drejta për mbrojtje dhe përfshirje sociale*

Politikat kombëtare për mirëqënien e fëmijëve (politikat sociale, shëndetësore, të edukimit, strehimit, etj.) duhet të synojnë promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Këto politika duhet t'u japin prioritet uljes së varfërisë dhe margjinalizimit, pabarazisë, mbështetjes së familjes, të adresojnë tolerancën dhe kohezionin social, të sigurojnë përfshirjen sociale dhe të nxisin bashkëpunimin e aktorëve të ndryshëm në të gjitha nivelet e qeverisjes.

Pranohet se çështja e përjashtimit të fëmijëve njihet shumë pak dhe se sistemi ekzistues i mbrojtjes sociale nuk është i orientuar drejt sigurimit të përkujdesit sipas grupeve të fëmijëve të përjashtuar. Megjithatë konstatohet se grupet e mëposhtme janë grupet e fëmijëve në situatë kritike ekonomike dhe shoqërore, si pasojë e të cilës të drejtat e tyre mohohen apo nuk respektohen. Këto grupe konsiderohen në nevojë për mbrojtje të veçantë.

**Fëmijët e familjeve më të varfra:** Fëmijët, familjet e të cilëve jetojnë me ndihmë ekonomike janë më të rrezikuarit nga përjashtimi social. Ato vuajnë nga disavantazhe të shumëfishta sociale pasi kanë vështirësi në marrjen e shërbimeve bazë si strehimi, edukimi, shërbimet shëndetësore dhe mbrojtja shoqërore.

**Fëmijët pa kujdes prindëror:** Analiza e të dhënave mbi numrin e fëmijëve të vendosur në institucione, si dhe dinamika e hyrjes dhe daljes nga këto institucionë tregon se afërsisht 60 përqind e fëmijëve vijnë nga familje të varfëra ose familje me probleme sociale, 35 përqind prej tyre janë të braktisur që në lindje dhe 5 përqind e tyre janë të vendosur në institucione për arsye të tjera, përfshirë këtu riatdhesimin e fëmijëve të trafikuar dhe fëmijët që punojnë[4].

**Fëmijë me aftësi të kufizuara:** Nga të dhënat administrative mund të njihet vetëm numri i individëve të cilët përfitojnë pagesë paaftësie sipas llojit të paaftësisë: mendore, fizike, pamësore apo dëgjimore. Mbështetur në analizën e të dhënave të përftuara nga dokumentat administrative rezulton se afro 60 përqind e fëmijëve me aftësi të kufizuara jetojnë në zonën rurale.

**Fëmijët që detyrohen të punojnë:** Në nivel kombëtar informacioni i saktë mungon, por së shpejti pritet një studim i INSTAT. Studimet lokale tregojnë se shumica e fëmijëve që punojnë në rrugë e kanë braktisur shkollën, ose e ndjekin atë me ndërprerje. Pranohet se një pjesë e konsiderueshme e familjeve rome dhe egjiptiane, u kërkojnë fëmijëve të punojnë për të ndihmuar familjen.

Megjithë mbështetjen që jep kuadri ligjor për dhënien e ndihmës në para apo në natyrë për familjet pa të ardhura apo masat që merren për ndihmën dhe reduktimin e varfërisë tek familjet dhe grupet në nevojë, ka nevojë për masa specifike për të mbështetur veçanërisht fëmijët, me bindjen se investimi tek fëmijët është burimi më i sigurtë i zhvillimit njerëzor dhe shoqëror në të ardhmen. Në përgjigje të nevojave në rritje për shërbime gjithëpërfshirëse cilësore sociale si edhe në përputhje me angazhimet e marra në kuadrin e procesit të integrimit në BE, Plani i Veprimit për Fëmijë 2012-2015, nënvizon domosdoshmërinë e një vëmendje të veçantë mbi nevojat e fëmijëve në programin e ndihmës ekonomike, me qëllim që ky program të ndikojë në zbutjen e varfërisë dhe parandalimin e fenomeneve sociale negative që rrisin përjashtimit e fëmijëve të varfër.

Në këtë plan janë parashikuar masa konkrete për programin e ndihmës ekonomike, duke patur për qëllim që të merren në konsideratë nevojat e fëmijëve dhe kushtëzimin me përmbushjen e këtyre nevojave nga familjet përfituese.

Në lidhje me të drejtat e mbrojtjes dhe përfshirjes sociale të fëmijëve, Plani i Veprimit synon të kontribuojë në arritjen e rezultateve strategjike:

1. ***Rritja e rolit të njësive të qeverisjes vendore, në vlerësimin e nevojave të fëmijëve në raport me realizimin e të drejtave të tyre dhe zbutjen e varfërisë.***
2. ***Reformimi i sistemit të shërbimeve sociale për fëmijë.***
3. ***Harmonizimi i politikave për të drejtat e fëmijëve nëpërmjet funksionimit të mekanizmave për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në nivel qendror dhe vendor.***

Në planin e veprimit, përcaktohen objektiva specifike sipas secilit Objektiv Strategjik.

***Objektivi strategjik 1,*** *"Rritja e rolit të njësive të qeverisjes vendore, në vlerësimin e nevojave të fëmijëve në raport me realizimin e të drejtave të tyre dhe zbutjen e varfërisë"* do të arrihet nëpërmjet objektivave: **1.** Hartimi dhe vlerësimi i politikave rajonale për

[4] Studimi "Vlerësimi i Institucioneve për fëmijët jashtë kujdesit prindëror", UNICEF

çdo qark, për realizimin e të drejtave të fëmijëve, duke marrë parasysh gjendjen ekonomiko-sociale të rajonit; **2.** Hartimi i politikave për zbutjen e varfërisë dhe përjashtimin social të fëmijëve në nevojë.

*Hartimi dhe miratimi i strategjive rajonale për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në çdo qark*, monitorimi i zbatimit të të drejtave të fëmijëve në çdo njësi administrative të qarkut, vlerësimi i politikave rajonale për fëmijët si edhe rritja e buxhetëve për politikat sociale rajonale që ndikojnë në zbatmin e të drejtave të fëmijëve janë disa nga masat që do të mundësojnë arritjen e objektivit 1.

Objektivi 2, *"Hartimi i politikave për zbutjen e varfërisë dhe përjashtimin social të fëmijëve në nevojë"*, si një objektiv themelor i të gjithë politikës sociale të vendit do të realizohet nëpërmjet pilotimit në disa njësi vendore të një skeme të re të mbështetjes me të ardhura për fëmijët që ndjekin arsimin e detyrueshëm, familjet e të cilëve janë në skemën e NE si edhe nëpërmjet rritjes së kapacitëtëve të NjDF si edhe strukturave të tjera të qeverisjes vendore (zyrat e ndihmës ekonomike) në lidhje me zbatimin më efektiv të ndihmës ekonomike në raport me të drejtat e fëmijëve.

**Objektivi strategjik 2 *"Reformimi i sistemit të shërbimeve sociale për fëmijë"*** do të arrihet nëpërmjet objektivave: **1.** Deinstitucionalizimi, transformimi i shërbimeve rezidenciale në tipologji të reja shërbmesh; **2.** Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve sociale për fëmijë; **3.** Zgjerimi i hartës së shërbimeve për fëmijë; **4.** Mbrojtje alternative për fëmijët e privuar nga kujdesi prindëror.

Në këtë kuadër, ngritja e shërbimeve ditore dhe komunitare për fëmijë, në qendrat rezidenciale të njësive të pushtetit vendor, sipas nevojave të komunitetit, shtrirja e tipologjisë shtëpi-familje në shërbimet rezidenciale të transferuara pranë NJQV, vlerësimi i zbatimit të standarteve të përkujdesit shoqëror për fëmijë në qendrat rezidenciale si edhe hartimi i standarteve për tipologjitë e reja të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për fëmijë, janë disa nga masat që do të mundësojnë arritjen e objektivit. Plani i veprimit për fëmijë përcakton se njësitë e qeverisjes vendore duhet të intensifikojnë përpjekjet për marrjen e përgjegjësive financiare, reformimin e institucioneve rezidenciale dhe ngritjen e shërbimeve të reja në përputhje me dinamikën e nevojave të fëmijëve në nevojë në komunitet e tyre.

Masa të posaçme janë parashikuar për implementimin e shërbimit të kujdestarisë për fëmijët në familje, si një nga alternativat më të mira në interesin më të lartë të fëmijës.

**Objektivi strategjik 3, *"Harmonizimi i politikave për të drejtat e fëmijëve nëpërmjet funksionimit të mekanizmave për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në nivel qëndror dhe vendor"*** kushtëzohet nga objektivat: **1.** Monitorimi dhe vlerësimi i imple-mentimit të politikave për realizimin e të drejtave të fëmijëve; **2.** Ngritja e një sistemi të unifikuar treguesish statistikorë për vlerësimin e realizimit të të drejtave të fëmijëve dhe përjashtimin social të fëmijëve në nivel kombëtar dhe në nivel qarku; 3.Vendosja e një partneriteti dhe nxitja e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve shtetërore në nivel qendror e vendor, si dhe organizatave jo-fitimprurëse që veprojnë në këtë fushë.

Arritja e këtyre objektivave mbështetet në hartimin dhe funksionimin e një pakete aktesh e vendimesh, në zbatim të ligjit 10347, datë 04.11.2010, në të cilët një vend të veçantë zë sigurimi i funksionimit të zbatimit të kuadrit ligjor për funksionimin e Këshillit Kombëtar për të Drejtat e Fëmijëve, të Agjencisë Shtetërore për të Drejtat e Fëmijëve, të institucioneve respektive në nivel rajonal si edhe sigurimi i fuqizimit dhe rritjes së numrit të personelit të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve me kapacitetet e duhuara njerëzore dhe infrastrukturore për ushtrimin e funksioneve dhe përgjegjësive të caktuara nga legjislacioni në fuqi.

Ngritja e një sistemi të unifikuar treguesish statistikorë për vlerësimin e realizimit të të drejtave të fëmijëve dhe përjashtimin social të fëmijëve në nivel kombëtar dhe në nivel qarku do të arrihet nëpërmjet miratimit dhe zbatimit të aktit nënligjor që përcakton llojin e informacionit statistikor për analizën e nivelit të realizimit të të drejtave të fëmijëve, mënyrën e përcjelljes së këtij informacioni nga pushteti vendor në ASHMDF, fuqizimit të sektorit të statistikës në ASHMDF dhe rrjetit të NJDF në qarqe si edhe nëpërmjet hartimit dhe miratimit të listës së treguesve të përjashtimit social të fëmijëve sipas KDF.

Politikat për fëmijët nuk mund të ndahen nga politikat për familjet. Politikat për fëmijët dhe familjet duhet:

- Të mbrojnë fëmijën dhe familjen nga varfëria dhe përjashtimi social;
- Të mbështësin familjen në ushtrimin e përgjegjësive prindërore dhe kujdesit ndaj fëmijëve;
- Të parandalojnë sa më shumë të jetë e mundur ndarjen e fëmijëve nga familjet e tyre;
- Të promovojnë shërbimet me bazë komunitare dhe shërbimet alternative (shtëpi-familje, kujdestari) ndaj shërbimit rezidencial për fëmijë;
- Të promovojnë forma pozitive dhe jo të dhunshme të përkujdesit për fëmijët, prindërimin pozitiv.

# Kapitulli 3

## *E drejta e fëmijëve për mbrojtje nga dhuna, abuzimi dhe shfrytëzimi ekonomik*

Çështjet që lidhen me krijimin e një ambienti mbrojtës për fëmijët gradualisht janë përfshirë në listën e prioriteteve të qeverisë gjatë dhjetëvjeçarit të fundit. Pikpamja mbi mbrojtjen sociale të fëmijëve ka ndryshuar nga njohja e të drejtave të tyre, në respektimin dhe garantimin e këtyre të drejtave. Sidoqoftë, trashëgimia e varfër e të kaluarës si edhe problemet ekonomike dhe shoqërore të Shqipërisë, kanë përcaktuar edhe drejtimet e politikave sociale të Shqipërisë. Si rezultat i situatës ekonomike dhe shoqërore si edhe i dukurive që lidhen me tranzicionin, fëmijët përballen me shumë dukuri kritike që ndikojnë në mohimin, përjashtimin apo mosrespektimin e të drejtave të tyre.

Megjithatë, përpjekjet në rritje të institucionëve qeveritare dhe shoqërisë civile kanë rezultuar në rritjen e vëmendjes ndaj grupeve të fëmijëve të përjashtuar ose në rrezik përjashtimi nga e drejta e mbrojtjes shoqërore. Politikat e hartuara apo në proces hartimi, synojnë jo vetëm të mbrojnë fëmijët, por të parandalojnë, zbulojnë dhe të përgjigjen ndaj formave të ndryshme të dhunës apo shfrytëzimit të fëmijëve.

Në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga ligji nr.10347 datë 04.11.2010, Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijëve, të cilat janë në proces krijimi në bashki e komuna, duhet të ushtrojnë funksionët e tyre si vijon:

Njësia për Mbrojtjen e Fëmijës në bashki/komunë funksionon brenda strukturës administrative të bashkisë/komunës, si njësi e posaçme ose si njësi e strukturave të ngarkuara me çështje sociale dhe ka për detyrë:

a. të vlerësojë dhe të monitorojë në vazhdimësi situatën e familjeve të fëmijëve në rrezik, derisa fëmija të konsiderohet "jo në rrezik";

b. të bëjë identifikimin dhe të bashkërendojë, në mënyrë multidisiplinare, mbrojtjen, referimin dhe analizën e rasteve në territorin e bashkisë/komunës;

c. të sensibilizojnë komunitetin, të organizojë takime informuese, edukuese dhe trajnuese për mbrojtjen e fëmijës në territorin e bashkisë/komunës;

d. të bashkëpunojë me administratorët e shërbimeve shoqërore, psikologët e shkollave, mjekun e familjes, autoritetet përgjegjëse të rendit, punonjësit socialë të qendrave të shërbimeve publike e jopublike, për përmirësimin e situatës së mbrojtjes së fëmijës në territorin e bashkisë/komunës;

e. të shërbejë si qendër informacioni, ku fëmijët dhe familjet në territorin e bashkisë/komunës mund të informohen apo të referohen te shërbime të tjera mbështetëse, sipas nevojave që ata kanë;

f. t'i raportojë periodikisht Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës të dhënat statistikore që ka përpunuar për mbrojtjen e fëmijës në territorin e bashkisë/komunës;

g. t'i paraqesë periodikisht Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës informacione për situatën e mbrojtjes se fëmijës në territorin e bashkisë/komunës.

Në lidhje me të drejtën e fëmijëve për mbrojtje nga dhuna, abuzimi dhe shfrytëzimi ekonomik, plani i veprimit për fëmijë 2012-2015 synon arritjen e objektivave strategjike:

1. ***Parandalimi dhe mbrojtja e fëmijëve nga dhuna, abuzimi.***
2. ***Mbrojtja e fëmijëve nga format më të këqija të punës.***

**Objektivi strategjik 1, *"Parandalimi dhe mbrojtja e fëmijëve nga dhuna, abuzimi"*** kushtëzohet nga objektivat: **1.** Rregjistrimi i të gjithë fëmijëve me shtetësi shqiptare, të lindur, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë; **2.** Ngritja dhe funksionimi i mekanizmave institucionalë në nivel vendor për mbrojtjen e fëmijëve dhe menaxhimin e rasteve te fëmijëve në rrezik; **3.** Zbatimi i programit COMBI: "Për një shkollë miqësore pro sjelljeve pozitive"; **4.** Vendosja dhe konsolidimi i shërbimit psikologjik në të gjitha kopshtet, shkollat e arsimit të detyruar dhe arsimit të mesëm; **5.** Internet i sigurtë për fëmijët.

Zbatimi i objektivit të parë synon rregjistrimin e të gjithë fëmijëve edhe të atyre që kanë mbetur të parregjistruar brenda afateve, për shkaqe të ndryshme, si një hap i parë për parandalimin dhe mbrojtjen e fëmijës nga çdo formë dhune, abuzimi, neglizhimi.

Objektivi 2, kërkon ngritjen e njësive për mbrojtjen e fëmijëve në çdo bashki/komunë, duke filluar nga bashkitë më të mëdha të vendit, miratimin dhe zbatimin VKM *"Për mekanizmin e bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve shtetërore përgjegjese për referimin e rasteve të fëmijëvenë rrezik"*, hartimin dhe miratimin e metodologjisë së veprimit të njësive për mbrojtjen e fëmijëve për trajtimin e rasteve të fëmijëve në rrezik, ngritjen dhe funksionimin e ekipeve teknike ndërdisiplinore në qarqe, bashki e komuna për menaxhimin e rasteve të fëmijëve në rrezik si edhe hartimin dhe miratimin e Statusit të Punonjësit Social.

Zbatimi i objektivit të dytë, kërkon që të përgatiten rregulloret tip të ekipeve teknike ndërdisiplinore në qarqe, bashki e komuna për menaxhimin e rasteve të fëmijëve në rrezik si edhe ngritjen e kapaciteteve të punonjësve të njësive të mbrojtjes/të drejtave të fëmijëve dhe grupeve teknike multidisiplinare në njësitë e qeverisjes vendore.

Objektivat 3 dhe 4 janë fokusuar në mbrojtjen e fëmijëve në institucionet e edukimit, shkolla, kopshte. Zbatimi i programit COMBI synon promovimin dhe zbatimin në shkolla të mënyrave të reja të disiplinimit (MRD) të fëmijëve dhe mobilizimin e komunitetit për respektimin e këtyre metodave të reja.

Shtrirja e shërbimit psikologjik në të gjithë kopshtet dhe shkollat në vend, është konsideruar një masë e domosdoshme dhe kërkesë e vazhdueshme e stafit pedagogjik në shkolla. Rritja e kapaciteteve të psikologëve të shkollave, hartimi i standarteve për cilësinë e punës së psikologëve, si edhe vendosja e bashkëpunimit ndërmjet psikologëve të shkollës dhe Njësive për Mbrojtjen e Fëmijëve në bashki/komunë për menaxhimin e rasteve të fëmijëve në rrezik, kushtëzojnë arritjen e objektivit 4 të përshkruar më lart.

Objektivi 5 *"Internet i sigurtë për fëmijët"* është një objektiv i ri dhe lidhet me nxitjen e praktikave të vetërregullimit ndërmjet siguruesve të shërbimit të internetit, institucioneve dhe aktorëve të tjerë të industrisë së komunikimit si dhe fushata ndërgjegjësimi, edukimi, informimi për sigurinë në internet, për të gjithë aktorët.

**Objektivi strategjik 2, *"Mbrojtja e fëmijëve nga format më të këqija të punës"*** do të arrihet nëpërmjet objektivave: **1.** Forcimi i masave për parandalimin dhe garantimin e një mbrojtje më efikase për fëmijët e shfrytëzuar në format më të rënda të punës; **2.** Rritja e rolit të Inspektoratit Shtetëror të Punës për mbrojtjen e fëmijëve dhe përmirësimin e situatës së fëmijëve që punojnë.

Objektivi për forcimin e masave për parandalimin dhe garantimin e një mbrojtje më efikase për fëmijët e shfrytëzuar në format më të renda të punës lidhet me ndryshimet në Kodin Penal, neni 124/b, lidhur me keqtrajtimin apo shfrytëzimin e fëmijëve nëpërmjet detyrimit për të punuar në rrugë, si dhe për punë që dëmtojnë shëndetin mendor dhe fizik të fëmijës.

Arritja e objektivave të mësipërme kërkon vendosjen e bashkëpunimit të ISHP me Njësinë e Mbrojtjes së Fëmijëve në bashki/komunë, forcimi i sanksionëve ndaj autorëve të formave më të këqija të punës, rritjen e kapaciteteve të inspektorëve të ISHP lidhur me çështjet e mbrojtjes së fëmijëve në rrezik, politikat e reja për bashkëpunimin e institucioneve në nivel vendor për menaxhimin e rasteve të fëmijëve në rrezik, forcimIn e inspektimeve duke përmirësuar monitorimin e punës së fëmijëve me fokus shëndetin e tyre dhe sigurinë në punë, si edhe përmirësimin e kuadrit ligjor për sigurinë dhe shëndetin në punë të fëmijëve.

# Kapitulli 4

## *E drejta për zhvillim dhe arsim*

E drejta e fëmijëve për zhvillim duke filluar që nga grupmosha 0-3 vjeç, trajtohet për herë të parë në një Plan Kombëtar Veprimi për Fëmijë duke vazhduar më pas me fëmijët e grupmoshave të tjera.

Politika për përfshirjen e fëmijëve në procesin e hartimit të programeve mësimore vjetore duhet të parashikohet edhe nëpërmjet akteve ligjore dhe nënligjore përkatëse duke siguruar që ata të jenë pjesë aktive e grupit të punës gjatë hartimit të kurrikulës dhe planeve të mësimit. Për këtë çështje në planin e veprimit janë parashikuar disa politika dhe masa konkrete, për rishikimin e kurrikulave dhe teksteve shkollore duke i afruar më shumë me fëmijët.

Kërkohet që toleranca ndaj braktisjes shkollore të jetë zero, objektiv i cili do të arrihet me anë të programeve intregruese në shkolla dhe programeve sociale në komunitet. Përfshirja në arsimim e të gjitha grupeve të fëmijëve, pavarësisht, gjendjes social-ekonomike të familjes, aftësive të tyre të kufizuara, përkatësisë në një grup etnik apo minoritar etj, është parashikuar të realizohet nëpërmjet përcaktimit të disa masave konkrete në përgjegjësi të qeverisjes qendrore dhe vendore.

Politikat e reja të ndërmarra në kuadër të reformës në arsim duhet të shoqërohen me ndryshimet e nevojshme në infrastrukturën shkollore, si dhe me përgatitjen e stafit pedagogjik në përshtatje me kurrikulat dhe mënyrat e reja të mësimdhënies.

Gjithashtu Plani i Veprimit ka parashikuar në përmbajtjen e tij politika dhe masa të posaçme për:

a. forcimin e komunikimit dhe transparencën e pushtetit vendor me fëmijët dhe grupet e interesit, lidhur me politikat arsimore për fëmijët, politika që do të zbatohen në nivel rajonal.

b. përmirësimin e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të ndryshme në nivel vendor për t'ju përgjigjur me mirë nevojave të fëmijëve në përgjithësi dhe të fëmijëve në nevojë në veçanti, për të siguruar përfshirjen e të gjithë fëmijëve në sistemin e detyruar arsimor.

c. nxitjen e formave alternative të mbështetjes së fëmijëve romë e në nevojë të veçantë, si edhe të familjeve të tyre me qëllim arsimimin e tyre.

Plani i Veprimit ka parashikuar masa me qëllim sigurimin e infrastrukturës së nevojshme dhe të përshtatshme shkollore, në zonat rurale, për të siguruar që proçesi mësimdhënës të zhvillohet në cilësinë e duhur, përmirësimin e kushteve higjeno-sanitare, si dhe instalimin dhe funksionimin e sistemit të ngrohjes.

Një drejtim tjetër shumë i rëndësishëm që shërben për garantimin e arsimimit cilësor të fëmijëve është edhe përmirësimi i mësimdhënies. Për të realizuar këtë objektiv janë parashikuar disa masa për rritjen e nivelit të kualifikimit të mësuesve si profesionistë dhe respektues të të drejtave të fëmijëve, vazhdimin e proçesit të reformimit të karrierës së mësuesit, proçes i cili ndikon thellësisht në rritjen e cilësisë së mësidhënies.

Qeveria e nxënësve, si organ legjitim i fjalës dhe organizimit të nxënësve brenda shkollës, është e domosdoshme të ketë pavarësi dhe status të veçantë nga drejtoria e shkollës. Në këtë kuadër, në Planin e Veprimit janë përcaktuar masa të cilat kërkojnë rishikimin e dispozitave normative, për t'i dhënë më shumë pavarësi qeverive të nxënësve.

Nga njësitë e qverisjes vendore kërkohet që të organizojnë më shumë veprimtari ndërgjegjësuese për të drejtat e fëmijëve jo vetëm brenda shkollës por edhe në komunitet, me iniciativën e vetë qeverive të nxënësve dhe të mbështeten këto iniciativa edhe në pikëpamjen financiare.

Gjykohet e arsyeshme që të organizohen aktivitete me qëllim shkëmbimin e eksperiencave dhe praktikave më të mira ndërmjet shkollave të ndryshme për sa i përket funksionimit të qeverive të nxënësve dhe pjesëmarrjes së tyre në jetën e komunitetit.

Strukturat e njësive të qeverisjes vendore, duhet të kenë në përbërjen e tyre këshilla, në të cilat edhe fëmijët marrin pjesë, ose këshilla të përbërë nga presidentët e qeverive të nxënësve të shkollave, si një detyrim moral dhe në zbatim të Konventës së Fëmijëve dhe kuadrit ligjor në Shqipëri për fëmijët, si dhe të krijohen kushtet për pjesëmarrje aktive të fëmijëve.

Plani i Veprimit ka parashikuar në përmbajtjen e tij, shtrirjen e mëtejshme të veprimtarisë së qeverisë së nxënësve edhe në komunitet, duke bërë të mundur sjelljen në vëmendje të problemeve që kanë fëmijët në komunitet.

Informimi dhe sensibilizimi i fëmijëve, për të drejtat e tyre, njohja nga ana e fëmijëve dhe e stafit mësimdhënës nëpër shkolla, vazhdon të mbetet një masë që duhet të aplikohet edhe për peridhën 2012-2015.

Në mënyrë të detajuar, realizimi i të drejtës për arsim në harkun kohor të veprimit të kësaj strategjie, do të përfshijë realizimin e objektivave strategjike:

1. ***Krijmi i një mjedisi që nxit zhvillimin e fëmijëve që në moshë të hershme,***
2. ***Sistem arsimor gjithpërfshirës dhe cilësor, për fëmijët.***
3. ***Rritja e pjesmarrjes së fëmijëve në procesin vendimarrës në shkollë dhe jashtë saj.***

**Objektivi strategjik 1, *"Krijmi i një mjedisi që nxit zhvillimin e fëmijëve që në moshë të hershme"*** do të arrihet nëpërmjet nxitjes së qeverisjes vendore për të promovuar zhvillimin e hershëm të fëmijëve.

Realizimi i këtij objektivi kërkon fillimisht studimin e situatës dhe problematikave për zhvillimin e hershëm të fëmijëve 0-3 vjeç, si dhe hartimin e standarteve dhe programeve këshilluese për përmirësimin e shërbimit që ju ofrohet fëmijëve 0-3 vjeç në çerdhe.

**Objektivi strategjik 2 *"Sistem arsimor gjithë-përfshirës dhe cilësor për fëmijët"***, do të arrihet nëpërmjet objektivave: **1.** Përmirësimi dhe konsolidimi i vazhdueshëm i sistemit arsimor publik cilësor dhe falas në nivelet e parashkollorit dhe në arsimin e detyruar; **2.** Gjithëpërfshirje në mësimnxënie pavarësisht gjendjes social-ekonomike të familjes, përkatësisë etnike, aftësisë së kufizuar apo vendodhjes gjeografike; **3.** Ulja e nivelit të braktisjes së shkollës.

Objektivi i parë kërkon rritjen e aksesit të fëmijëve në arsim parashkollor, ndërtimin e kopshteve të reja, rehabilitimin e atyre ekzistuese dhe plotësimin me pajisjet e domosdoshme për një funksionim dinjitoz, duke këmbëngulur në përmirësimin në vazhdimësi të kurikulës shkollore, duke synuar shmangien e ngarkesave të tepërta si dhe duke patur në konsideratë zhvillimin e fëmijëve. Realizimi i këtij objektivi kërkon krijimin dhe forcimin e infrastrukturës të përshtatshme mësimdhënëse në shkollat e arsimit të detyruar dhe arsimit të mesëm, me qëllim rritjen e efektivitetit në përvetësimin e kurrikulës arsimore që përmirësohet në mënyrë të vazhdueshme e shoqëruar me rritjen e kapaciteteve mësimdhënëse.

Objektivi i dytë synon rritjen e numrit të rregjistrimit të fëmijëve romë, egjyptianë dhe me aftësi të kufizuar, në arsimin e detyruar, ndërtimin e kopshteve të reja në zonat e banuara nga popullsia rome, përfshirjen me prioritet të fëmijëve romë në arsimin parashkollor dhe mësimi i gjuhës shqipe për t'i përgatitur për klasën e parë, hartimin e një akti normativ që rregullon punën e individualizuar me fëmijë me nevoja të veçanta si edhe rritjen e numrit të mësuesve asistentë që punojnë me fëmijët me aftësi të kufizuar.

Realizimi i objektivit të tretë kërkon zbatimin e ligjit për arsimimin e detyrueshëm, kthimi në shkollë i fëmijëve që nuk e kanë përfunduar (pra braktisur atë) dhe ofrimi i alternativave të formimit profesional për të rinjtë në moshë pune, hartimin e programeve të veçanta pune në nivel klase dhe shkolle, me qëllim sensibilizimin e prindërve dhe fëmijëve për rëndësinë e shkollimit, dhe për kthimin në shkollë të fëmijëve jashtë sistemit arsimor, identifikimin e fëmijëve që braktisin shkollën dhe zhvillimi i programeve dhe projekteve për të parandaluar fenomenin dhe rikthimin në shkollë të tyre, identifikimi i saktë i fëmijëve të ngujuar si pasojë e gjakmarrjes si dhe zbatimin e programeve arsimore dhe projekteve në ndihmë të këtij kontigjenti fëmijësh me qëllim garantimin e të drejtës së tyre për arsimim.

**Objektivi strategjik 3, *"Rritja e pjesëmarrjes së fëmijëve në procesin vendimmarrës në shkollë dhe jashtë saj"*** kushtëzohet nga objektivat: **1.** Pjesëmarrja e vazhdueshme dhe cilësore e fëmijëve në vendimarrjet për mënyrën e zhvillimit të procesit mësimor, si dhe në veprimtaritë brënda dhe jashtë shkollës; **2.** Promovimi i të drejtave të fëmijëve.

Rritja e pjesëmarrjes së fëmijëve në vendimmarrje kërkon plotësimin e akteve normative të funksionimit të shkollës, që i njohin të drejtën fëmijëve të jenë pjesëmarrës në vendimarrjet që lidhen me procesin mësimor, veprimtaritë brënda dhe jashtë shkollës si dhe të përcaktohen instrumentat dhe modalitetet që do të bëjnë efektive këtë pjesëmarrje në disa drejtime si:

a. informimin dhe marrjen e vendimeve së bashku me trupin pedagogjik,
b. marrjen e përgjegjësive kundrejt vetvehtes, shkollës, familjes dhe komunitetit,
c. praktikimit të formave të delegimit dhe përfaqësimit,
d. pjesëmarrjes në këshillat drejtuese të shkollës si edhe monitorim të zgjedhjes dhe të funksionimit të qeverisë së nxënësve.

# Kapitulli 5

## *E drejta për kujdes shëndëtësor*

E drejta për kujdes shëndetësor, në harkun kohor pesë vjeçar do të realizohet nëpërmjet arritjes të katër objektivave strategjikë:

1. ***Sigurimi i kujdesit esencial shëndetësor për nënën dhe fëmijën;***
2. ***Parandalimi i kequshqyerjes, obezitetit dhe mbipeshës tek fëmijët;***
3. ***Parandalimi i sëmundjeve ngjitëse dhe reduktimi i nivelit të sëmundjeve kryesore të fëmijërisë;***
4. ***Kontrolli dhe parandalimi HIV/AIDS dhe IST.***

Arritja e secilit nga rezultatet udhëhiqet nga disa objektiva, të cilat në vetvete përfshijnë një listë të gjerë masash komplekse.

Arritja e sigurimit të kujdesit esencial shëndetësor për çdo foshnje të porsalindur **(Objektivi strategjik 1)** është një standard i domosdoshëm për uljen e vdekshmërisë foshnjore. Për arritjen e këtij rezultati është e nevojshme të arrihen objektivat: **1.** Monitorimi dhe vlerësimi i shërbimeve shëndetësore për nënën dhe foshnjen e porsalindur; **2.** Sigurimi, që çdo institucion kujdesi shëndetësor për nënën dhe fëmijën, të ofrojë kujdes efektiv dhe bashkëkohor për ushqyerjen me gji duke zbatuar 10 hapat për një ushqyerje të suksesshme me gji.

Me qëllim realizimin e objektivit të parë, plani i veprimit tërheq vëmëndjen mbi monitorimin, vëzhgimin si edhe auditimin e cilësisë së shërbimit të kujdesit neonatal nga shërbimet e kujdesit në maternitet si dhe trajnimin e personelit që ofron kujdes obstetrikal dhe neonatal mbi praktikat e kujdesit për foshnjën e porsalindur. Ndër treguesit kryesorë që përcaktojnë arritjen e këtij rezultati strategjik janë numri i institucioneve shëndetësore të akredituara si dhe numri i punonjësve të trajnuar mbi kujdesin për të porsalindurit.

Për arritjen e objektivit të dytë, kërkohet që të përforcohet zbatimi i ligjit për mbrojtjen dhe nxitjen e ushqyerjes me gji, nxitjen e gjithë shërbimeve të maternitetit në vend që të promovojnë praktikat më të mira të Iniciativës "Spitale Mike të fëmijës" të OBSH/UNICEF që përputhen me 10 hapat e ushqyerjes me gji, nxitjen e pjesëmarrjes së medias për të paraqitur ushqyerjen e shëndetshme me gji si edhe përfshirjen e treguesve të ushqyerjes me gji në sistemin e monitorimit dhe vlerësimit të punës së institucioneve të kujdesit shëndetësor për nënën dhe fëmijën. Arritja e këtij objektivi do të ndikojë ndjeshëm në përmirësimin e treguesve shëndetësorë si të nënës ashtu dhe të fëmijës.

**Objektivi strategjik 2, *"Parandalimi i kequshqyerjes, obezitetit dhe mbipeshës tek fëmijët, ushqyerja e shëndetshme"*** tërheq vëmëndjen mbi të gjitha çështjet që lidhen me ushqyerjen e shëndetshme për fëmijët. Aktualisht, ushqimi i fëmijëve mbetet një ndër problemet kryesore për shëndetin e fëmijëve. Ky rezultat synon garantimin e ushqyerjes së shëndetshme për fëmijët dhe do të arrihet nëpërmjet objektivit: **1.** Zbatimi i programeve kombëtare për të promovuar të ushqyerit e shëndetshëm dhe aktivitetin fizik të fëmijëve, si dhe organizimin e aktiviteteve promocionale shëndetsore për ndërgjegjësimin e familjeve dhe komunitetit për mënyrat e shëndetshme të ushqyerjes dhe aktivitetit fizik tek fëmijët, të ndjeshme ndaj komponentit gjinor. Arritja e këtij objektivi do të përmirësojë ushqyerjen e fëmijëve dhe do të zvogëlojë numrin e fëmijëve të kequshqyer.

Realizimi i të vetmit objektiv të këtij rezultati parashikon zbatimin e një sërë masash që lidhen me politika shëndetsore, politika sociale dhe politika ndërgjegjësimi. Studimi dhe vlerësimi i situatës paraprakisht nga mjekët e kopshteve dhe shkollave për kequshqyerjen, mbipeshën dhe obezitetin, ofrimi i kujdesit të specializuar individual dhe me bazë gjinore, sigurimi i mbështetjes emocionale për fëmijët e kequshqyer, mbipeshë dhe obezë, si edhe përfshirja në kurrikulat shkollore të edukimit, e informacionit mbi ushqyerjen e shëndetshme të fëmijëve, janë disa nga masat që synojnë parandalimin e kequshqyerjes dhe të pasojave të saj negative në të ardhmen.

Gjithashtu, rritja e aktivitetit fizik të fëmijëve në programet shkollore dhe në lëndët jashtë programit, përcaktimi i udhëzuesve dietikë për fëmijët sipas nevojave që ato kanë në lidhje me moshën dhe gjininë, përgatitja e protokolleve të unifikuara për ndjekjen e rregullt të rritjes dhe zhvillimit të fëmijëve nga personeli i kujdesit shëndetësor parësor, trajnimi i punonjësve të kujdesit shëndetësor lidhur me ushqyerjen dhe këshillimin për ushqyerjen, përfshirja e treguesve lidhur me ushqyerjen e fëmijës në sistemin e monitorimit të performancës së qendrave shëndetësore si edhe organizimi i fushatave nxitëse në media për ushqyerjen e shëndetshme tek fëmijët

dhe adoleshentët, plotësojnë kuadrin e veprimit për arritjen e ndërgjegjësimit të shoqërisë, të komunitetit si edhe të vetë familjeve për domosdoshmërinë e ushqyerjes së shëndetshme.

**Objektivi strategjik 3, *"Parandalimi i sëmundjeve ngjitëse dhe reduktimi i nivelit të sëmundjeve kryesore të fëmijërisë"*** synohet të arrihet nëpërmjet vaksinimit të plotë e në kohë të gjithë fëmijëve sipas kalendarit kombëtar të vaksinimit, vendosjes të një sistemi të unifikuar për monitorimin e cilësisë dhe sistemit të survejimit për imunizimin e popullsisë, monitorimit të rritjes dhe zhvillimit të fëmijëve 0-5 vjeç si dhe zgjerimi i modelit MISF (Menaxhimi i Integruar i Sëmundejve të Fëmijërisë). Arritja e këtij objektivi do të ndikojë në rritjen e mbulesës vaksinale tek fëmijët si dhe në pakësimin e nivelit të sëmundjeve kryesore të fëmijërisë.

Arritja e këtij rezultati udhëhiqet nga objektivat: **1.** Vaksinimi i plotë në kohë të gjithë fëmijëve sipas kalendarit kombëtar të vaksinimit. Monitorimi i cilësisë së vaksinave dhe survejimi për imunizim i popullatës; **2.** Monitorimi i rregullt i rritjes dhe zhvillimit të fëmijëve 0-5 vjeç nga personeli i kujdesit shëndetësor parësor në qendrat shëndetësore dhe këshillimoret e fëmijës; **3.** Zgjerimi i modelit të MISF (Menaxhimi i Integruar i Sëmundjeve të Fëmijërisë) për ndjekjen dhe trajtimin e fëmijëve 0-5 vjeç në të gjitha shërbimet e KSHP të kujdesit për fëmijën

Vaksinimi i plotë dhe në kohë i të gjithë fëmijëve sipas kalendarit përkatës, do të arrihet nëpërmjet rritjes së mbulesës vaksinale tek fëmijët, zgjerimit të skemës së kalendarit të vaksinimit nëpërmjet futjes së vaksinave te reja si edhe të përfshirjes në kalendarin e vaksinimit të grupeve të margjinalizuara, (p.sh popullata rome).

Vendosja e një sistemi të unifikuar për monitorimin e cilësisë të imunizimit në të gjithë popullsinë kërkon zbatimin e programeve kombëtare për vaksinimin që ju targetohen nënave me status të ulet social ekonomik dhe arsim të ulët, përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit të zinxhirit ftohës dhe trainimit të personelit përkatës për ruajtjen sa më efektive të vaksinave si edhe organizimin e kontrolleve periodike të situatave epidemiologjike për sëmundjet infektive dhe joinfektive.

Monitorimi i rregullt i rritjes dhe zhvillimit të fëmijëve 0-5 vjeç nga personeli i kujdesit shëndetësor parësor në qendrat shëndetësore dhe këshillimoret e fëmijës parashikon përcaktimin e protokolleve të unifikuara, rregulloreve, etj për monitorimin e rregullt të rritjes dhe zhvillimit të fëmijës si edhe trajnimin e vazhdueshëm të personelit shëndetësor lidhur me monitorimin e rritjes, zhvillimit si dhe përmirësimin e aftësive këshilluese lidhur me shëndetin e fëmijës.

Parandalimi i problemeve të rritjes, zhvillimit dhe reduktimi i nivelit të sëmundjeve kryesore të fëmijërisë nëpërmjet strategjisë së MISF (Menaxhimi i integruar i sëmundjeve të fëmijëve) do të arrihet kryesisht nëpërmjet monitorimit të rregullt të rritjes dhe zhvillimit të fëmijëve 0-5 vjeç nga personeli i kujdesit shëndetësor parësor në qëndrat shëndetësore dhe këshillimoret e fëmijës si dhe trajnimit të personelit shëndetësor lidhur me ndjekjen e rritjes, dhe zhvillimin e fëmijës. Zbatimi i këtij objektivi do të ndikojë në uljen e vdekshmërisë dhe sëmundshmërisë foshnjore dhe fëminore, rritjen dhe zhvillimin e shëndetshëm të fëmijëve dhe përmirësimin e cilësisë të kujdesit shëndetësor të ofruar nga shërbimet KSHP për shëndetin e fëmijëve.

**Objektivi strategjik 4, *"Kontrolli dhe parandalimi HIV/AIDS dhe IST (infeksionet seksualisht të transmetueshme)"*** tek fëmijët është një ndër prioritetet më kryesore në garantimin e mbrojtjes së shëndetit të fëmijëve. Ky rezultat udhëhiqet nga objektivi "parandalimi dhe ulja e rasteve të HIV/AIDS dhe IST te fëmijët". Ky objektiv mund të realizohet në sajë të përcaktimit dhe ngritjes së qendrave të referencës nëpër maternitete për parandalimin e transmetimit të HIV/AIDS nga nëna te fëmija, përfshirjes së informacionit mbi HIV/AIDS në kurrikulat shkollore dhe ofrimit të informacionit mbi parandalimin e HIV/AIDS dhe IST në publik dhe në veçanti për grupet në rrezik. Rezultatet e zbatimit të plotë të këtij objektivi janë ulja e rasteve të HIV/AIDS dhe IST te fëmijët dhe sensibilizimi i fëmijëve për rrezikun e HIV/AIDS dhe IST.

Ndonëse në planin e veprimit nuk përcaktohen masa të veçanta në lidhje me parandalimin e dhunës, aksidenteve e dëmtimeve fizike e psikologjike të fëmijëve, kjo çështje, meqenëse konsiderohet si ndër/institucionale nënvizohet si objektiv në vëmëndje të disa institucioneve. Dhuna, aksidentet, traumat dhe dëmtimet në shtëpi, familje, komunitet, përbëjnë aktualisht një fenomen të përhapur tek fëmijët, ndaj parandalimi i tyre paraqet rëndësi të veçantë. Kjo do të arrihet kryesisht në sajë të një fushate për ndërgjegjësimin mbi rrezikun e drejtimit të automjeteve nën influencën e alkoolit, drogave dhe hartimit të protokolleve për menaxhimin e fëmijëve dhe adoleshentëve që vuajnë nga pasojat e dhunës në familje në shërbimet e kujdesit shëndetësor për fëmijën. Arritja e këtij objektivi do të ndikojë në uljen e vdekshmërisë, sëmundshmërisë dhe paaftësive tek fëmijët, të shkaktuar nga dhuna, trauma dhe aksidentët.

# Kapitulli 6

## *E drejta për mbrojtje ligjore*

Reforma në drejtësinë për të mitur ka njohur progres gjatë viteve të fundit. Ministria e Drejtësisë është angazhuar në hartimin e një strategjie të re sektoriale për drejtësinë për të mitur, e cila do të ketë për qëllim trajtimin e të gjithë problemeve ligjore që hasin fëmijët në Shqipëri.

Vazhdimësia e politikave ekzistuese si edhe hartimi i politikave të reja në fushën e drejtësisë për të miturit, synojnë në arritjen e disa objektivave strategjike:

1. ***Mbrotja e fëmijëve në konflikt me ligjin,***
2. ***Sigurimi i mbrojtjes së duhur për fëmijët nën moshën 14 vjeç, në konflikt me ligjin,***
3. ***Mbrojtja e fëmijëve viktima dhe dëshmitarë të krimit.***

Arritja e **objektivit strategjik 1**, ***"Mbrotja e fëmijëve në konflikt me ligjin"***, kërkon realizimin e objektivave që lidhen me: **1.** Rritja e efikasitetit të procedimeve ligjore ndaj të miturve si dhe shkurtimi i afateve kohorë të tyre; **2.** Rritja e përdorimit të masave alternative të dënimit me burgim dhe efikasitetit të ekzekutimit të vendimeve penale për të mitur; **3.** Rehabilitimi dhe rintegrimi i fëmijëve në konflikt me ligjin

Rritja e efikasitetit të procedimeve ligjore ndaj të miturve si edhe shkurtimi i afateve kohore të tyre është një proces kompleks, që do të realizohet nëpërmjet përmirësimit të aksesit në sistemin e drejtësisë nëpërmjet krijimit të seksioneve të të miturve në të gjithë gjykatat e shkallës së parë. Krijimi i gjashte seksioneve të të miturve ka qenë një hap pozitiv në drejtim të krijimit të nje trupe të specializuar për gjykimin e të miturve. Në të njëjtën kohë, është vështirësuar aksesi në drejtësi, për familjet dhe fëmijët (në përgjithësi me një situatë ekonomike të rënduar) që detyrohen të largohen nga qyteti i tyre për ndjekjen e procesit gjyqësor. Kjo ka krijuar mjaft probleme si financiare, po ashtu dhe të vonesave në procedurat e hetimit dhe gjykimit. Pasja e seksioneve të të miturve në çdo gjykatë (përfshi dhe gjykatat me numër të vogël rastesh, ku gjykatësi mund të trajtojë dhe raste të tjera në varësi të ngarkesës) do ta përmirësonte ndjeshëm këtë anomali. Kjo do të pasohet edhe nga krijimi i dhomës së gjyqtarëve për të mitur. Sigurisht trainimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve për të mitur me praktikat më të mira në administrimin e drejtësisë për të mitur mbetet një prioritet edhe në këtë Plan Veprimi.

Dhoma për të mitur e cila do të ngrihet në Gjykatat ekzistuese, për shkak të specializimit të tyre, do të rrisë ndjeshëm cilësinë e vendimeve, do të shkurtojë afatet kohore të procedimeve ligjore ndaj të miturve si dhe efikasitetin e tyre. Për më tepër, një reformë e tillë do të shënonte një hap të rëndësishëm në përmbushjen e standardeve evropiane në këtë fushë.

Objektivi 2 *"Rritja e përdorimit të masave alternative të dënimit me burgim dhe efikasitetit të ekzekutimit të vendimeve penale për të mitur"* do të arrihet nëpërmjet rritjes së efiçiencës së zbatimit të dënimeve alternative për të miturit në të gjithë territorin nëpërmjet forcimit të shërbimit të provës. Shërbimi i provës, që zbaton dënimet alternative, ka nevojë të zgjerojë prezencën e tij në të gjithë territorin, si dhe të përmirësojë cilësinë e dhënies së shërbimit.

Rritja e aplikimit të praktikave më të mira në zbatimin e dënimeve alternative për të mitur, kërkon hartimin e rregulloreve e protokolleve të veçanta për zbatimin e këtyre masave.

Ligji i ri për ndërmjetësimin rregullon licensimin e ndërmjetësve, si dhe detyron krijimin e një dhome për të miturit. Licensimi është në proces dhe krijimi i dhomës së ndermjetësve është një masë që pritet te realizohet brenda 2012

Në objektivin 3 "Rehabilitimi i të miturve në konflikt me ligjin" synohet përmirësimi i kuadrit ligjor për dhënien dhe ekzekutimin e vendimeve penale për të mitur. Në nenin 5 të ligjit Nr.8331, datë 21.4.1998, " Për Ekzekutimin e Vendimeve Penale" përcaktohet qartë që: "Ekzekutimi i vendimeve për të miturit dhe gratë bëhet në vende dhe në mënyra të veçanta e favorizuese". Aktualisht vepron vetëm një I.E.V.P ndaj të miturve në Kavajë, por nevojitet krijimi i institucioneve të tjera në mënyrë që të miturit të mos vuajnë më dënimin nëpër seksionet e I.E.V.P siç është vepruar deri më sot, por në I.E.V.P të specializuara për ta. Në këtë mënyrë kushtet e dënimit do të ishin më të përballueshëm për të miturit dhe rehabilitimi i tyre në shoqëri do të lehtësohej ndjeshëm. Krijimi i Institucioneve të Ekzekutimit të Vendimeve Penale për të Mitur, vendosja e treguesve të matshëm për

vlerësimin e cilësisë së shërbimeve në këto I.E.V.P si edhe sigurimi i arsimit dhe edukimit të fëmijëve në institucionet e paraburgimit dhe në burgje, janë disa masa të tjera të parshikuara në Planin e Veprimit.

**Objektivi strategjik 2, *"Sigurimi i mbrojtjes së duhur për fëmijët nën moshën 14 vjeç në konflikt me ligjin"*** përbën një shqetësim të vazhdueshëm. Përfshirja në aktivitetet kriminale të të miturve nën 14 vjeç, të cilët për shkak të moshës nuk trajtohen nga sistemi i drejtësisë, mbetet një problem. Me qëllim mbrojtjen sa më efikase të fëmijëve të kësaj kategorie si dhe për arsimimin e tyre do të hartohet një projekt ligj "Për masat edukative për fëmijët nën 14 vjeç në konflikt me ligjin".

Realizimi i këtij rezultati kërkon: **1.** Plotësim të kuadrit ligjor për fëmijët në konflikt me ligjin nën moshën (14 vjeç); **2.** Ndikim i drejtpërdrejtë në rehabilitimin e tyre në shoqëri. Plani i veprimit parashikon se hartimi i një projekt ligji për masat edukative për fëmijët nën 14 vjeç në konflikt me ligjin, ngritja e shërbimeve të reja që kanë për qëllim ofrimin e shërbimeve të nevojshme, sigurimi i përkujdesjes së duhur psikologjike për fëmijët e kësaj kategorie si edhe vendosja e treguesve për matjen e rrezikut të përhapjes së aktiviteteve kriminale për fëmijët e kësaj kategorie, do të mundësojnë arritjen e objektivave të mësipërme.

**Objektivi strategjik 3, *"Mbrojtja e fëmijëve viktima dhe dëshmitarë të krimit"***, kushtëzohet nga objektivat: **1.** Përmirësimi i kuadrit ligjor lidhur me mbrojtjen e fëmijëve, viktima dhe dëshmitarë të krimit; **2.** Përmirësimi i trajtimit të të miturve si viktima dhe dëshmitarë.

Në Planin e Veprimit parashikohen masa për ndryshime në Kodin e Proçedurës Penale dhe Kodin Penal lidhur me trajtimin e të miturve si viktima dhe dëshmitarë të krimit, hartimin e protokolleve të trajtimit të të miturve si viktima dhe dëshmitarë, përshtatja e ambjenteve të policisë ku intervistohen dhe mbahen të miturit, trainimi i gjykatësve, prokurorëve, policisë gjyqësore, avokatëve dhe punonjësve socialë.

# Vlerësime përfundimtare

## *Probleme kritike dhe masa të karakterit të përgjithshëm që lidhen me efektivitetin e zbatimit të planit të veprimit*

Me qëllim rritjen e bashkëpunimit me institucionet e qeverisë lokale (qark, bashki e komunë) si edhe për ndërgjegjësimin e shoqërisë në lidhje me çështjet e të drejtave të fëmijëve, kërkohet që në vazhdimësi, institucionet përgjegjëse të ngarkuara për zbatimin e planit të veprimit të:

1. Nxisin ngritjen e njësive për mbrojtjen e fëmijëve bashki/komunë, strukturë e rëndësishme në nivel lokal për menaxhimin e rasteve të fëmijëve në rrezik.
2. Bashkëpunojnë me ASHMDF, njësitë për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve qark, bashki/komunë, për të garantuar realizimin e të drejtave të fëmijëve.
3. Rrisin bashkëpunimin ndërmjet përfaqësuesve të pushtetit në nivel qendror dhe në nivel vendor.
4. Tërheqin vëmendjen e hartuesve të politikave mbi domosdoshmërinë e përfshirjes së të drejtave të fëmijëve në politikat dhe strategjitë rajonale, duke siguruar edhe financimet përkatëse.

Komponent i rëndësisë së veçantë mbetet promovimi i të drejtave të fëmijëve dhe tërheqja, pjesëmarrja aktive e vetë fëmijëve në përpjekjen për realizimin e të drejtave të tyre. Në mënyrë që mbrojtja e të drejtave të fëmijëve të jetë sa më efikase duhet që këta të fundit si dhe të rriturit të jenë të ndërgjegjshëm për to. Rol kyç në këtë proces duhet të luajnë institucionët arsimore si dhe mediat. Për këtë arsye, miratimi i planit të veprimit do të shoqërohet nga një fushatë promovuese, në qendër të së cilës janë vetë fëmijët. Zhvillimi i një fushatë të tillë, synon ndërgjegjësimin e publikut të gjerë mbi të drejtat e fëmijëve në përgjithësi si dhe mbi Planin e Veprimit për Fëmijët 2012-2015 në veçanti.

Pavarësisht nga vendi që zë komponenti shoqëror në përpjekjet për të zbatuar planin e veprimit për fëmijë dhe të drejtat e fëmijëve në përgjithësi, çështja e të drejtave të fëmijëve kërkon angazhim serioz institucional, në radhë të parë të institucioneve që hartojnë politika, jo vetëm sociale, por edhe ekonomike e të zhvillimit.

Dentralizimi financiar dhe mundësitë reale të pushtetit vendor për hartim dhe zbatim të politikave rajonale; rritja e rolit të pushtetit vendor dhe pjesëmarrja qytetare në respektimin e të drejtave të fëmijëve përfaqësojnë sfida të përgjithshme, por të domosdoshme të zhvillimit të politikave të të drejtave të fëmijëve. Këto sfida kërkojnë pjesëmarrjen e motivuar të të gjithë aktorëve, të hartuesve të politikave, të zbatuesve të politikave, të organizatave të shoqërisë civile, të institucioneve qeveritare, jo qeveritare e të biznesit privat, të mediave, të vetë fëmijëve, të qytetarëve dhe të gjithë shoqërisë shqiptare, sepse:

1. Të gjithë mund të luajnë rolin e tyre edhe si qytetarë, edhe si familjarë, edhe si ofrues dhe realizues shërbimesh, edhe si të treja së bashku;
2. Nëse veprimet nuk janë të përbashkëta, të gërshetuara dhe të harmonizuara, rezultati i kërkuar nuk do të arrihet asnjë herë;
3. Çështja e fëmijëve është çështje e të gjithëve, sepse fëmijët jo vetëm nuk mund t'i zgjidhin vetë problemet e tyre, por janë motivi kryesor i punës, luftës dhe përpjekjeve tona të përbashkëta.
4. Fëmijët janë garancia më e fuqishme e ndërtimit të një të ardhmeje të sigurtë për Shqipërinë.

# Plani i masave për zbatimin e objektivave strategjike, 2012-2015

| OBJEKTIVAT | MASAT | INSTITUCIONET PËRGJEGJËSE/ BASHKËPUNUES | AFATI | BURIMET E ZBATIMIT (Million lek) | TREGUESIT |
|---|---|---|---|---|---|
| **E Drejta për Mbrojtje dhe Përfshirje Sociale** | | | | | |
| **Objektivi Strategjik 1. *Rritja e rolit të njësive të qeverisjes vendore, në vlerësimin e nevojave të fëmijëve në raport me realizimin e të drejtave të tyre dhe zbutjen e varfërisë.*** | | | | | |
| 1. Hartimi dhe vlerësimi i politikave rajonale për çdo qark, për realizimin e të drejtave të fëmijëve, duke marrë parasysh gjendjen ekonomiko-sociale të rajonit. | 1.1 Hartimi dhe miratimi i Strategjive rajonale për mbrojtjen e të drejtat e fëmijëve.<br><br>1.2 Monitorimi dhe vlerësimi i zbatimit të politikave për të drejtat e fëmijëve në çdo njesi administrative të qarkut.<br><br>1.3 Rritja e buxheteve për politikat sociale rajonale që ndikojnë në zbatimin e të drejtave të fëmijëve. | Këshillat e Qarqeve, NJDF, ASHMDF, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Observatorët e të drejtave të fëmijëve në qarqe. | 2012-2014<br><br>Çdo vit<br><br>Çdo vit | Buxheti i qeverisjes vendore, UNICEF | 1. Numri i qarqeve që kanë miratuar strategji rajonale për të drejtat e fëmijëve.<br><br>2.Numri i raporteve të progresit dhe vlerësimit të zbatimit të strategjive.<br><br>3. % e rritjes së buxhetit për fëmijë në fushën e arsimit, shëndetësisë, mbrojtjes sociale në çdo qark. |
| 2.Hartimi i politikave për zbutjen e varfërisë dhe përjashtimin social të fëmijëve në nevojë. | 2.1 Pilotimi në disa njësi vendore, i një skeme të re të ndihmës për fëmijët që ndjekin arsimin e detyrueshëm, familjet e të cilëve janë në skemën e NE.<br><br>2.2 Rritja e kapaciteteve të NJDF si edhe strukturave të tjera të qeverisjes vendore(zyrat e ndihmës ekonomike) në lidhje me zbatimin më efektiv të ndihmës ekonomike në raport me të drejtat e fëmijëve. | MPÇSSHB<br>NJQV<br>NJDF<br>UNICEF | 2012 | Buxheti i shtetit, brenda fondit për NE | 1. Numri i NJQV për pilotim.<br><br>2. Hartimi i akteve nënligjore në zbatim të ndryshime të ligjit Nr 9355 dt 05.12.2006 për pilotimin.<br><br>3. Numri i NJDF dhe stafit të zyrave të NE në NJQV, të trajnuar. |

| **Objektivi Strategjik 2.** ***Reformimi i sistemit të shërbimeve sociale për fëmijë*** | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 1. Deinstitucionalizimi Transformimi i shërbimeve rezidenciale në tipologji të reja shërbimesh. | 1.1 Ngritja e shërbimeve ditore dhe komunitare për fëmijë, në qendrat rezidenciale të njësive të pushtetit vendor, sipas nevojave të komunitetit.<br><br>1.2 Transformimi fizik i godinave ekzistuese të shërbimit rezidencial, në formën shtëpi-familje.<br><br>1.3 Shtrirja e tipologjisë shtëpi-familje në shërbimet rezidenciale të transferuara pranë NJQV. | MPÇSSHB, SHSSH, NJQV, OJF | 2012-2015 | Viti 2012 – 121.9<br>Viti 2013 – 106.4<br>Viti 2014 – 124.0 | 1. Numri i shërbimeve të reja për fëmijë.<br><br>2.Transformimi i qendrave rezidenciale në Sarandë, Shkodër, Tiranë, Vlorë, Korçë.<br><br>3.Numri i shtëpive-familje në shërbimet rezidenciale dhe numri i fëmijëve që trajtohen aty. |
| 2.Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve sociale për fëmijë. | 2.1 Vlerësimi i zbatimit të standarteve të përkujdesit shoqëror për fëmijë në qendrat rezidenciale.<br><br>2.2 Hartimi i standarteve për tipologjitë e reja të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për fëmijë.<br><br>2.3 Mbështetja me fonde dhe ekspertizë e 14 shërbimeve rezidenciale të decentralizuara e të transferuara në pushtetin vendor në rrethet Tiranë, Korçë, Shkodër, Lezhë, Durrës, Vlorë, Berat, Sarandë. | Inspektoriati i shërbimeve shoqërore<br>NJQV, MPÇSSHB<br>OJF | Çdo vit<br><br>2012-2015 | Viti 2012 – 1.8<br>Viti 2013 – 1.8<br>Viti 2014 – 1.9 | 1. Raportet e inspektoriatit të shërbimeve.<br><br>2. Standartet e reja të miratuara. |
| 3. Zgjerimi i hartës së shërbimeve për fëmijë Bashkëpunim me NJQV dhe donatorë të | 3.1 Mbledhja e të dhënave dhe krijimi i një database rreth shërbimeve sociale që ofrohen sipas qarqeve dhe bashkive përkatëse. | MPÇSSHB, NJQV, UNICEF | 2012 | Dixhitalizimi i sistemit të mbrojtjes sociale<br>Viti 2012 – 0.09<br>Viti 2013 – 0.6 | 1.Harta e shërbimeve sociale në nivel kombëtar dhe sipas NJQV. |

| OBJEKTIVAT | MASAT | INSTITUCIONET PËRGJEGJËSE/ BASHKËPUNUES | AFATI | BURIMET E ZBATIMIT (Million lek) | TREGUESIT |
|---|---|---|---|---|---|
| ndryshëm për ngritjen e shërbimeve të reja. | 3.2 Nxitja e Njësive të Qeverisjes Vendore për hartimin e planeve zonale, ku përcaktohen edhe nevojat e shërbimeve për fëmijë.<br><br>3.3 Marrëveshje dhe kontrata bashkëpunimi me donatorët për ngritjen e shërbimeve të reja për fëmijë, bazuar në hartën e nevojave për shërbim. | | 2012-2015 | | 2. Planet zonale ku përcaktohen nevojat e komunitetit për shërbimet për fëmijë.<br><br>3. Numri i kontratave të lidhura të NJQV me ofrues shërbimesh për fëmijë. |
| 4. Mbrojtje alternative për fëmijët e privuar nga kujdesi prindëror.<br><br>. | 4.1 Vlerësim i procesit të pilotimit të shërbimit të kujdestarisë.<br><br>4.2 Miratimi P/VKM "Përcaktimi i kritereve, dokumentacionit dhe procedurës së shërbimit të kujdestarisë.<br><br>4.3 Ngritja e Komiteteve të Vlerësimit të Familjeve kujdestare në 6 bashki.<br><br>4.4 Arsimimi dhe formimi profesional i familjeve kujdestare.<br><br>4.5 Trajnimi i anëtarëve të komisioneve që përzgjedhin familjen kujdestare, gjykatësve, punonjësve socialë, etj. | MPÇSSHB<br>UNICEF<br><br>MPÇSSHB<br><br>NJQV<br>SHSSH<br><br>SHSSH<br><br>SHSSH, UNICEF | 2012<br><br>2012<br><br>2013<br><br>2013-2015<br><br>2013-2015 | Buxheti i shtetit | 1.Raporti i vlerësimit të pilotimit.<br><br>2.VKM e miratuar.<br><br>3.Numri i Komiteteve të vlerësimit të ngritura.<br><br>4.Numri i familjeve kujdestare të trajnuara.<br><br>5.Numri anëtarëve të komisioneve të trajnuar. |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | 4.6 Sistemimi i fëmijëve në familje nëpërmjet birësimit brenda dhe jashtë vendit.<br><br>4.7 Përmirësimi i shërbimit të birësimit, në funksion të mbrojtjes së të drejtave të të miturve. | KSHB<br><br>MD<br>KSHB | 2012-2013<br><br>2012-2013 | Viti 2012 - 39<br><br>Viti 2012 - 3.8 | 6. Numri i fëmijëve të birësuar.<br>7. Monitorime periodike nëpër institucione publike dhe jopublike për zbatimin e afateve ligjore për fillimin e proçedurave për birësim.<br>8. Hartimi i standarteve të shërbimit të birësimit.<br>9.Monitorime të periudhës pasbirësuese. |
| **Objektivi Strategjik 3.** ***Harmonizimi i politikave për të drejtat e fëmijëve nëpërmjet funksionimit të mekanizmave për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në nivel qendror dhe vendor*** *(Këshilli Kombëtar për të Drejtat e Fëmijeve, Ministri që bashkërendon punën për çështjet e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve, Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve, NJDF në qarqe)* | | | | | |
| 1. Monitorimi dhe vlerësimi i zbatimit të politikave për realizimin e të drejtave të fëmijëve. | 1.1 Hartimi i raporteve periodike të vlerësimit të realizimit të të drejtave të fëmijëve dhe paraqitja për diskutim në Këshillit Kombëtar për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve.<br><br>1.2 Përmirësimi i politikave për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, zbatueshmërisë së tyre dhe bashkëpunimit institucional, mbështetur në rekomandimet e Këshillit Kombëtar për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës, apo nga vlerësimi i gjëndjes së respektimit/ mbrojtjes të të drejtave të fëmijës. | ASHMDF<br>Ministritë e linjës<br>NJQV, shoqëria civile<br><br>KKDF<br>MPÇSSHB<br>ASHMDF | Çdo vit<br><br>Çdo 6 muaj | MPÇSSHB<br>Viti 2012 – 3.6<br>Viti 2013 – 4.9<br>Viti 2014 – 5.04<br><br>Monitorimi i Planit të Veprimit për Fëmijë, 2012-2015.<br>Viti 2012 – 1.6<br>Viti 2013 – 2.3<br>Viti 2014 – 2.6 | 1. Raportet vjetore te gjendjes së realizimit të të drejtave të fëmijëve.<br><br>2. Mbledhjet e KKDF për të diskutuar mbi situatën e të drejtave të fëmijëve në vend, çdo 6 muaj.<br><br>3. Rekomandimet e dala nga mbledhja e KKDF.<br><br>4. Numri i seminareve për qark lidhur me ligjin e ri për të drejtat e fëmijëve dhe aktet e tij nënligjore.<br><br>5. Numri i trajnimeve për stafin e ASHMDF. |

| OBJEKTIVAT | MASAT | INSTITUCIONET PËRGJEGJËSE/ BASHKËPUNUES | AFATI | BURIMET E ZBATIMIT (Million lek) | TREGUESIT |
|---|---|---|---|---|---|
| | 1.3 Organizimi i seminareve në çdo qark me aktorë të ndryshëm (shëndetësia, policia, arsimi, shërbimet sociale, drejtësia, OJF, fëmijë) lidhur me kuadrin e ri ligjor për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. | ASHMDF, NJQV, Donatorë | Në vazhdimësi | | 6. Rritja e numrit të stafit të ASHMDF. |
| | 1.4 Rritja e numrit të stafit dhe ngritja e kapaciteteve të personelit të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve për monitorimin e zbatueshmërisë së ligjit dhe vlerësimin e situatës së realizimit të të drejtave në vend. | | Në vazhdimësi | | |
| 2.Ngritja e një sistemi të unifikuar treguesish statistikorë për vlerësimin e realizimit të të drejtave të fëmijëve dhe përjashtimin social të fëmijëve në nivel kombëtar dhe në nivel qarku. | 2.1 Miratimi i aktit nënligjor që përcakton llojin, informacionin statistikor për realizimin e të drejtave të fëmijëve dhe mënyrën e përcjelljes së këtij informacioni nga pushteti vendor në ASHDMF. | MPÇSSHB ASHMDF | Mars 2012 | | 1. Akti nënligjor i miratuar.<br>2. Institucionet përgjegjëse përcjellin informacionin statistikor të kërkuar në ASHMDF.<br>3. Numri trajnimeve të sektorit të statistikës në ASHMDF dhe rrjetit të NJDF në qarqe.<br>4. Lista e treguesve e përfshirë në legjislacioni për mbledhjen e statistikave. |
| | 2.2 Fuqizimi i sektorit të statistikës në ASHMDF dhe rrjetit të NJDF në qarqe. | ASHMDF, NJDF, UNICEF, | 2012-2013 | Buxheti i shtetit UNICEF | |
| | 2.3 Hartimi dhe miratimi i listës së treguesve të përjashtimit social të fëmijëve sipas KDF. | INSTAT | 2012 | | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 3. Vendosja e një partneriteti dhe nxitja e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve shtetërore në nivel qendror e vendor, Organizatave Jo fitimprurëse që veprojnë në këtë fushë. | 3.1 Miratimi i kuadrit nënligjor në zbatim të ligjit për fëmijët lidhur me:<br>a. Koordinimin e veprimtarisë së mekanizmave në nivel qëndror dhe vendor për çështjet që lidhen me mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.<br>b. Bashkëpunimin midis mekanizmave institucionalë për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe organizatave jo fitimprurëse.<br>c. Vendosjen e sanksioneve për rastet e moszbatimit të ligjit. | MPÇSSHB<br>ASHMDF | Mars 2012 | MPÇSSHB<br>Viti 2012 - 1.77<br>Viti 2013 - 1.88<br>Viti 2014 - 1.92 | 1. VKM-të e miratuara.<br>2. Marrëveshjet e nënshkruara ndërmjet institucioneve shtetërore dhe OJF.<br>3. Numri i seminareve të organizuara dhe numri i pjesmarrësve në to. |
| | 3.2 Takime në çdo qark, me të gjithë aktorët në nivel vendor për realizimin e akteve nënligjore të mësipërme. | ASHMDF, institucione shtetërore, NJQV, OJF | 2012-2013 | | |
| | 3.3 Marreveshje bashkëpunimi ndërmjet Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmi-jëve apo institucioneve shtetërore përgjegjëse me OJF që veprojnë në fushën e të drejtave të fëmijëve. | ASHMDF, institucione shtetërore, NJQV, OJF | Në vazhdimësi | | |

| OBJEKTIVAT | MASAT | INSTITUCIONET PËRGJEGJËSE/ BASHKËPUNUES | AFATI | BURIMET E ZBATIMIT (Million lek) | TREGUESIT |
|---|---|---|---|---|---|
| **E Drejta për Mbrojtje nga Dhuna, Abuzimi dhe Shfrytëzimi Ekonomik** | | | | | |
| **Objektivi Strategjik 1.** ***Parandalimi dhe mbrojtja e fëmijëve nga dhuna, abuzimi*** | | | | | |
| 1. Regjistrimi i të gjithë fëmijëve me shtetësi shqiptare, të lindur, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë. | 1.1 Përmirësimi i kuadrit ligjor për regjistrimin e fëmijëve. | MB | 2013 | Buxheti i MB, për Gjendjen Civile<br>Viti 2012– 0.1<br>Viti 2013– 0.1<br>Viti 2014– 0.1 | 1.Miratimi i akteve nënligjore. |
| | 1. 2 Evidentimi i të gjithë fëmijëve të paregjistruar. | NJQV (Zyrat e Gjendjes Civile, NJMF, OJF | Në vazhdimësi | | 2.Mbajtja e aktit të lindjes për të gjithë fëmijët e lindur brenda vendit. |
| | 1.3 Bashkëpunimi ndërmjet zyrave të gjendjes civile, gjykatave, NJMF për të lehtësuar regjistrimin e fëmijëve të paregjistruar brenda afateve. | DPGJC, NJQV (Zyrat e Gjendjes Civile, NJMF, OJF | Në vazhdimësi | | 3.Mbajtja e aktit të lindjes / regjistrimi për të gjithë fëmijët e lindur jashtë vendit. |
| | 1.4 Përfitimi i shpërblimit nga regjistrimi i çdo fëmije. | NJQV | Në vazhdimësi | | |
| 2. Ngritja dhe funksionimi i mekanizmave institucionale në nivel vendor për mbrojtjen e fëmijëve dhe menaxhimin e rasteve të fëmijëve në rrezik. | 2.1 Takime në çdo qark, me kryetarët e qarqeve, kryetarët e bashkive dhe komunave për njohjen e ligjit të ri dhe detyrimet e pushtetit vendor në zbatim të ligjit. | Këshillat e qarqeve, NJQV ASHMDF, UNICEF, Shoqëria civile | 2012 | MPÇSSHB<br>Viti 2012 - 1.82<br>Viti 2013 - 1.91<br>Viti 2014 - 2.09 | 1.Numri i takimeve dhe i pjesmarrrësve. |
| | 2.2.Ngritja e njësive për mbrojtjen e fëmijëve në çdo bashki/komunë (fillimisht në bashkitë e mëdha) dhe e 2 njësive për të drejtat e fëmijëve. | Këshillat e qarqeve, NJQV, Donatorët | 2012-2015 | | 2.Numri i NJMF dhe NJDF të ngritura. |
| | 2.3 Miratimi P/VKM Për mekanizmin e bashkërendimit të punës ndërmjet | ASHMDF MPÇSSHB | Mars 2012 | | 3. VKM e miratuar. |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | autoriteteve shtetërore përgjegjëse për referimin e rasteve të fëmijëve në rrezik, si dhe mënyrën e procedimit të tij. | | | | |
| | 2.4 Hartimi dhe miratimi i Metodologjisë së veprimit të njësive për mbrojtjen e fëmijëve/mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve për trajtimin e rasteve të fëmijëve në rrezik. | ASHMDF<br>MPÇSSHB | 2013 | | 4. Udhëzimi i Ministrit për Metodologjinë e veprimit të njësive për mbrojtjen e fëmijëve/ mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve për trajtimin e rasteve të fëmijëve në rrezik. |
| | 2.5 Ngritja dhe funksionimi i ekipeve teknike ndërdisiplinore në qarqe, bashki e komuna për menaxhimin e rasteve të fëmijëve në rrezik. | NJQV e në Këshillat e qarqeve | Në vazhdimësi | | 5. Takimet e grupeve multidisiplinare për menaxhimin e rastit të fëmijëve në rrezik. |
| | 2.6 Përgatitja e rregulloreve tip dhe miratimi i rregulloreve të funksionimit të Komiteteve Drejtues në qarqe dhe të ekipeve teknike multidisiplinore në bashki e komuna për menaxhimin e rasteve të fëmijëve në rrezik. | ASHMDF<br>NJQV e në Këshillat e qarqeve | 2014 | | 6. Rregullore të miratuara në qarqet ku janë ngritur Komitetet Drejtues dhe në NJQV ku janë ngritur ekipet teknike multidisiplinore. |
| | 2.7 Ngritja e kapaciteteve të punonjësve të njësive të mbrojtjes së fëmijëve/mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve, grupeve teknike multidisiplinare në njësitë e qeverisjes vendore. | NJQV, Institucio-net shtetërore përgjegjëse në nivel vendor, ASHMDF, Donatorët | Në vazhdimësi | | 7. Numri i trajnimeve dhe personave të trajnuar. |
| | 2.8 Hartimi dhe miratimi i Statusit të Punonjësit Social. | MPÇSSHB | 2013 | | 8.Statusi i punonjësit social i miratuar. |
| | 2.9 Monitorimi i menaxhimit të rasteve të fëmijëve në rrezik. | ASHMDF | Në vazhdimësi | | 9.Numri i kontrolleve. |

| OBJEKTIVAT | MASAT | INSTITUCIONET PËRGJEGJËSE/ BASHKËPUNUES | AFATI | BURIMET E ZBATIMIT (Million lek) | TREGUESIT |
|---|---|---|---|---|---|
| 3. Zbatimi i programit COMBI: "Për një shkollë miqësore pro sjelljeve pozitive". | 3.1 Ngritja e grupit të avokatëve të mënyrave të reja të disiplinimit (MRD) në të gjitha shkollat e arsimit parauniversitar. | UNICEF | 2012-2013 | | 1. Numri i avokatëve në të gjitha shkollat e arsimit parauniersitar. |
| | 3.2 Seanca trajnimi për zbatimin e MRD. | Në të gjitha DAR/ZA | 2012-2014 | | 2. Numri i mësuesve dhe drejtuesve të shkollave të trajnuar. |
| | 3.3 Promovimi dhe zbatimi i MRD në shkolla, nëpërmjet medias dhe sensibilizimit të komunitetit. | Në të gjitha DAR/ZA | Në vazhdimësi | | 3. Numri i aktiviteteve promovuese në nivel DAR/ZA.<br>4. Emisione televizive dhe radiofonike. artikuj sensibilizues në shtypin e përditshëm.<br>5. Krijimi i Aleancave Rajonale të MRD (DAR/ZA komunitetit i prindërve). |
| | 3.4 Vlerësimi i impaktit të zbatimit të programit COMBI. | MASH, UNICEF | 2015 | | 6. Raporte mujore për diskutimin e zbatimit të MRD në të gjithë shkollat e arsimit parauniversitar.<br>7. Raporte vlerësuese për zbatimin e MRD në fillim dhe në fund të zbatimit të programit COMBI. |
| 4. Vendosja dhe konsolidimi i shërbimit psikologjik në të gjitha kopshtet, shkollat e arsimit të detyruar dhe arsimit të mesëm. | 4.1 Shtrirja e shërbimit psikologjik në të gjithë kopshtet dhe shkollat në vend. | MASH, DAR/ZA, UNICEF | 2012-2014 | Konsolidimi i shërbimit psikologjik ;<br>Viti 2012- 7.5;<br>Viti 2013-12;<br>Viti 2014- 20 | 1. Numri i shkollave që kanë psikolog. |
| | 4.2 Rritja e kapaciteteve të psikologëve të shkollave. | | | | 2. Trajnimi i psikologëve (250). |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | 4.3 Vendosja e bashkë-punimit ndërmjet psiko-logëve të shkollës dhe Njësive për Mbrojtjen e Fëmi-jëve në bashki/komunë për menax-himin e rasteve të fëmijve në rrezik. | | | | 3.Ngritja e sistemit koordinues dhe supervizues së SHPSH. |
| 5.Internet i sigurtë për fëmijët | 5.1 Nxitja e praktikave të vetërregullimit ndërmjet siguruesve të shërbimit të internetit, institucioneve dhe aktorëve të tjerë të industrisë së komunikimit.<br><br>5.2 Fushata ndërgjegjësimi , edukimi, informimi për sigurinë në internet, për të gjithë aktorët, operatorët celularë, ISP, ofruesit e shërbimeve, prindërit, fëmijët etj. | MITIK<br>AKSHI<br>operatorët celularë, ISP providers. | 2012-2013<br><br>2013-2015 | Buxheti i shtetit<br>donatorë | 1. Një Kod Kombëtar sjelljeje, etike ndërmjet të gjithë aktorëve.<br><br>2. Marrëveshje bashkëpunimi ISP, operatorëve celularë etj.<br><br>3. Nënshkrimi i marrëveshjeve të Bashkëpunimit ndërmjet institucioneve shtetërore dhe biznesit. |
| **Objektivi Strategjik 2.** ***Mbrojtja e fëmijëve nga format më të këqija të punës*** | | | | | |
| 1.Forcimi i masave për parandalimin dhe garantimin e një mbrojtje më efikase për fëmijët e shfrytëzuar në format më të rënda të punës. | 1.1 Ndryshimi i Kodit Penal, neni 124/b, lidhur me keqtrajtimin apo shfrytëzimin për lypësi, punë që dëmtojnë shëndetin mendor dhe fizik të fëmijës.<br><br>1.2 Fushatë sensibilizuese kundër shfrytëzimit për punë të fëmijëve.<br><br>1.3 Vlerësim, studim i punës së fëmijëve. | MD<br><br>BKTF<br><br>INSTAT | 2012<br><br>Çdo vit<br><br>2012 | Buxheti i shtetit<br>donatore | 1. Miratimi i ndryshimeve në Kodin Penal.<br><br>2. Aktivitete ndërgjegjësuese në të gjithë qarqet e vendit.<br><br>3. Studimi i INSTAT për punën e fëmijëve. |
| 2.Rritja e rolit të Inspektoratit Shtetëror të Punës për mbrojtjen | 2.1 Vendosja e bashkëpunimit të ISHP me Njësinë e Mbrojtjes së Fëmijëve në bashki/komunë. | ISHP,<br>NJQV(NJMF) | 2012-2015 | MPÇSSHB<br>Viti 2012 - 121.86<br>Viti 2013 - 106.41<br>Viti 2014 - 124 | 1.Institucionalizim i bashkëpunimit në përputhje edhe me Ligjin për inspektimin Nr10433 dt 16.6.2011 |

| OBJEKTIVAT | MASAT | INSTITUCIONET PËRGJEGJËSE/ BASHKËPUNUES | AFATI | BURIMET E ZBATIMIT (Million lek) | TREGUESIT |
|---|---|---|---|---|---|
| e fëmijëve dhe përmirësimin e situatës së fëmijëve që punojnë. | 2.2 Rritja e kapaciteteve të inspektorëve të ISHP lidhur me çështjet e mbrojtjes së fëmijëve në rrezik, politikat e reja për bashkëpunimin e institucioneve në nivel vendor për menaxhimin e rasteve të fëmijëve në rrezik. | ISHP | 2012-2013 | | 2. Trajnimi i 120 inspektorëve të ISHP.<br><br>3.Hartimi i Strategjisë së Inpektimit në Punë 2013-2020 duke i dhënë një fokus të veçantë punës së të miturve. |
| | 2.3 Forcimi i inspektimeve duke përmirësuar monitorimin e punës së fëmijëve me fokus shëndetin e tyre dhe sigurinë në punë. | ISHP | Në vazhdimësi | | |
| | 2.4 Përmirësimi i politikave kuadrit ligjor për sigurinë dhe shëndetin në punë të fëmijëve. | MPÇSSHB, ISHP | 2013 | | |
| **E Drejta për Zhvillim dhe Arsim** | | | | | |
| **Objektivi Strategjik 1.** ***Krijmi i një mjedisi që nxit zhvillimin e fëmijëve që në moshë të hershme*** | | | | | |
| 1.Pusheti vendor ka aftesitë dhe buxhetet e nevojshme për të promovuar zhvillimin e hershëm të fëmijëve. | 1.1 Studim kombëtar për problematikat dhe rekomandimet për të promovuar zhvillimin e hershëm të fëmijëve 0-3 vjeç. | UNICEF, NJQV ASHMDF | 2012 | Buxheti i NJQV, UNICEF | 1. Studimi kombëtar është zhvilluar dhe ka evidentuar problematikat dhe hapat për të ardhmen. |
| | 1.2. Hartimi i standardeve për fëmijët 0-3 vjeç në çerdhe. | ASHMDF MPÇSSHB, UNICEF | 2013 | | 2. Standardet për çerdhet, për fëmijët 0-3 vjeç, janë përgatitur dhe miratuar. |
| | 1.3 Rritja e kapaciteteve të pushtit lokal dhe aktorëve të tjerë për të hartuar, buxhetuar dhe zbatuar | UNICEF, ASHMDF NJQV | 2013-2015 | | 3. Buxheti i pushtetit lokal për fëmijët 0-3 vjeç është rritur me 5%. |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | politika për fëmijët 0-3 vjeç, duke i dhënë përparësi grupeve të fëmijëve në nevojë. | | | | 4. Programe prindërimi sidomos me fokus shtresat në nevojë janë krijuar dhe implementuar. |
| | 1.4 Hartimi i programeve këshilluese për prindërimin pozitiv. | UNICEF, ASHMDF NJQV | 2013 | | |
| **Objektivi Strategjik 2.** ***Sistem arsimor gjithpërfshires dhe cilësor, për fëmijët*** | | | | | |
| 1. Përmirësimi dhe konsolidimi i vazhdueshëm i sistemit arsimor publik cilësor dhe falas në nivelet e parashkollorit, arsimit të detyruar. | 1.1 Rritja e aksesit të fëmijëve në arsimin parashkollor. Ndërtimi i kopshteve të reja, rehabilitimi i atyre ekzistuese dhe kompletimi me orendi e pajisje. | MASH | 2012-2014 | Viti 2012 - 2,8;<br>Viti 2013 - 2,9;<br>Viti 2014 - 3,1 | 1. Rritje e numrit të fëmijëve 5 vjeçar me 10% dhe fëmijëve 3-4 vjeçarë në arsimin parashkollor.<br>2. Numri kopshteve të reja dhe atyre të rikonstruktuara. |
| | 1.2 Përmirësimi në vazhdimësi i kurrikulës, duke synuar shmangien e ngarkesave të tepërta si dhe duke patur në konsideratë zhvillimin e fëmijëve. | | 2012-2015 | | 3. Rishikimi i kurrikulave të arsimit të detyruar. |
| | 1.3 Përmirësimi i kushteve në shkolla, ndërtimi i shkollave të reja, rehabilitimi i atyre ekzistuese. | | 2012-2015 | Viti 2012-29,3;<br>Viti 2013-30,3;<br>Viti 2014- 33,3 | 4. Numri i shkollave të reja për arsimin e detyruar.<br>5. Përqindja e buxhetit të shtetit dhe Përqindja e fondeve që do të alokohen nga të ardhurat e njësive të qeverisjes vendore për përhapjen e shkollave të reja dhe përmirësimin e infrastrukturës ekzistuese në to. |
| | 1.4 Krijimi në shkollat e arsimit të detyruar dhe arsimit të mesëm i infrastrukturës mësimdhënëse që rrit shkallën e kërkimit, efektivitetin | MASH | 2012-2015 | | 6. Ngritja apo rehabilitimi i bibliotekave.<br>Ngritje e kabineteve dhe laboratorëve |

| OBJEKTIVAT | MASAT | INSTITUCIONET PËRGJEGJËSE/ BASHKËPUNUES | AFATI | BURIMET E ZBATIMIT (Million lek) | TREGUESIT |
|---|---|---|---|---|---|
| | e përvetësimit të kurrikulës arsimore që përmirësohet. | | | | Sigurimi i lidhjes me internet dhe laboratorët e teknologjisë |
| | 1.5 Rritja e nivelit të formimit dhe trajnimit të mësuesit. | | 2012-2015 | Trajnimet<br>Viti 2012- 25.8;<br>Viti 2013-26;<br>Viti 2014- 29.2 | 7.Hartimi dhe përgatitja e modeleve alternative për trajnimin e mësuesve dhe zhvillimin e vazhdueshëm profesional te mësuesve në përputhje me nevojat e tyre |
| 2. Gjithëpërfshirje në mësimnxënie pavarësisht gjendjes social-ekonomike të familjes, përkatësisë etnike, aftësisë së kufizuar apo vendodhjes gjeografike. | 2.1 Rritja e numrit të regjistrimit të fëmijëve romë, egjyptianë dhe me AK në arsimin e detyruar<br>2.2 Përfshirja me prioritet i fëmi-jëve romë në arsimin parashkollor dhe mësimi i gjuhës shqipe për t'i përgatitur për klasën e parë. | MASH, OJF NJQV | 2012-2015 | Buxheti i shtetit | 1. Rritja e treguesit të regjistrimit me 4.5% ose 160 fëmijë për nxënësit romë dhe egjiptianë, 2% për nxënësit me AK |
| | 2.3 Përmirësimi i kurrikulave, hartimi i programeve, metodave të punës që lehtësojnë procesin e të nxënit të fëmijëve me AK. | MASH | | | 2. Programe pune, kurrikula për fëmijët me AK që studiojnë në shkolla |
| | 2.4 Hartimi i akteve nënligjore për arsimimin e fëmijëve me nevoja të veçanta. | MASH | 2014 | | 3. Aktet e miratuara |
| | 2.5 Rritja e aksesit në arsimin e detyruar të fëmijëve që vijnë nga familje në gjendje të vështirë social ekonomike dhe nga vendbanime të largëta. | MASH, OJF NJQV | 2012-2015 | Kompensimi i vlerës së teksteve<br>Viti 2012 – 0.2<br>Viti 2013 – 0.2<br>Viti 2013 – 0.2 | 4. Vazhdimi i shpërndarjes së teksteve falas në arsimin e detyruar 9-vjeçar, për të siguruar aksesin e duhur në arsim të fëmijëve që i përkasin |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Shërbimi i trans-portit për mësuesit<br>Viti 2012 - 0.3<br>Viti 2013 – 0.3<br>Viti 2014 – 0.3 | familjeve përfituese të Ndihmës ekonomike.<br><br>5. Vendosja e transportit për fëmijët dhe mësuesit. |
| 3. Ulja e nivelit të braktisjes së shkollës. | 3.1 Kthimi në shkollë i fëmijëve që nuk e kanë përfunduar (pra braktisur atë) dhe ofrimi i alternativave të formimit profesional për të rinjtë në moshë pune. | MASH<br>MPÇSSHB | Çdo vit | Buxheti i shtetit | 1. Uljen e braktisjes shkollore në AB nën 0.3%. |
| | 3.2 Hartimi i programeve të veçanta pune në nivel klase dhe shkolle, me qëllim sensibilizimin e prindërve dhe fëmijëve për rëndësinë e shkollimit, dhe për kthimin në shkollë të fëmijëve jashtë sistemit arsimor. | MASH<br>DAR/ZA<br>NJMF<br>OJF | Çdo vit | | |
| | 3.3 Identifikimi i saktë i fëmijëve të ngujuar si pasojë e gjakmarrjes dhe zbatimi i programeve arsimore dhe projekteve në ndihmë të këtij kontigjenti fëmijësh. | MASH<br>DAR/ZA<br>NJMF<br>OJF | Çdo vit | | |

| OBJEKTIVAT | MASAT | INSTITUCIONET PËRGJEGJËSE/ BASHKËPUNUES | AFATI | BURIMET E ZBATIMIT (Million lek) | TREGUESIT |
|---|---|---|---|---|---|
| **Objektivi Strategjik 3. *Rritja e pjesëmarrjes së fëmijëve në procesin vendimarrës në shkollë dhe jashtë saj*** | | | | | |
| 1 Nxitja e pjesmarrjes së vazhdueshme dhe cilësore të fëmijëve në vendimarrje për mënyrën e zhvillimit të procesit mësimor, si dhe në veprimtaritë brenda dhe jashtë shkollës. | 1.1 Plotësimi i akteve normative të funksionimit të shkollës, që i njohin të drejtën fëmijëve të jenë pjesëmarrës në vendimarrjet që lidhen me procesin mësimor, veprimtaritë brenda dhe jashtë shkollës.<br>1.2 Ndërgjegjësimi i njësive të qeverisjes vendore për rolin e organizatave të fëmijëve.<br>1.3 Rritja e kapacitetit të QN. | MASH<br><br>NJQV<br><br>OJF, MASH | | Nuk kërkon fonde të posaçme, kryhen brenda buxhetit të miratuar të institucioneve | 1. Hartimi i instrumentave dhe modaliteteve për pjesmarrjen e fëmijëve në:<br>a. informimin dhe marrjen e vendimeve së bashku me trupin pedagogjik.<br>b. të marrin përgjegjësi kundrejt vetvetes, shkollës, familjes dhe komunitetit.<br>c. të praktikojnë forma të delegimit dhe përfaqësimit.<br>d. të marrin pjesë në bordet drejtuese të shkollës monitorim të zgjedhjes dhe të funksionimit të qeverisë së nxënësve. |
| 2. Promovimi i të drejtave të fëmijëve. | 2.1 Hartimi dhe shpërndarja nëpërmjet rrugëve të ndryshme të komunikimit të materialeve, informacionit lidhur me të drejtat e tyre dhe mundësitë ligjore për të mbrojtur këto të drejta.<br>2.2 Organizimi i fëmijëve për ushtrimin e të drejtës dhe përgjegjësive të tyre pjesmarrëse në vendimarrje të rëndësishme të shkollës dhe jashtë saj.<br>2.3 Organizatat e fëmijëve marrin pjesë, aktive në realizimin e të drejta-ve të tyre gjatë procesit mësimor | MASH, KMD, ASHMDF Qeveritë e nxënësve nëpër shkolla. | Në vazhdimësi | | 1. Lloji i materialeve të shpërndara.<br>2. Numri i shkollave ku janë shpërndarë.<br>3. Numri i QN të trajnuar.<br>4. Lloji i aktiviteteve ku fëmijët kanë ushtruar të drejtën e tyre për pjesmarrje (në shkolla, struktura vendimmarrëse në NJQV). |

## E Drejta për Kujdes Shëndetësor

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **Objektivi Strategjik 1. *Sigurimi i kujdesit esencial shëndetësor për nënën dhe fëmijën*** | | | | | |
| 1. Monitorimi dhe vlerësimi i shërbimeve shëndetësore për nënën dhe foshnjën e porsalindur. | 1.1. Kujdesi për gruan shtatëzënë që muajt e parë të shtatzanisë.<br><br>1.2 Sigurimi i kujdesit esencial për të gjitha foshnjet e porsalindura përfshirë reanimacionin, kontrollin e temperaturës dhe fillimin e hershëm të ushqyerjes me gji.<br><br>1.3. Përgatitja e protokolleve për kujdesin neonatal në çdo nivel shërbimi lidhur me kujdesin për të porsalindurin.<br><br>1.4. Trajnimi për të gjithë punonjësit e kujdesit shëndetësor të përfshirë në ofrimin e kujdesit obstetrikal dhe neonatal , lidhur me praktikat e kujdesit holistik për lindjen dhe e kujdesin për foshnjen e porsalindur.<br><br>1.5 Auditimi i rregullt i cilësisë së shërbimit të kujdesit shëndetësor për nënën dhe foshnjën e porsalindur. | MSH, ISKSH | Në vazhdimësi 2012-2015 | Viti 2012- 7,8<br>Viti 2013- 8,4<br>Viti 2014- 8,8 | 1. Zvogëlim i vdekshmërisë foshnjore me 3% në vitin 2014 nga niveli bazë i vitit 2012.<br>Zvogëlimi i vdekshmërisë amtare me 2% në vitin 2014 nga niveli aktual i 2012.<br><br>2. Përqindja e grave shtatëzënë që marrin vizitën e parë brenda tremujorit të parë të shtatzanisë.<br><br>3.Përqindja e grave që asistohen nga personel mjekësor gjatë lindjes.<br><br>4.Numri protokolleve të përgatitura për kujdesin për të porsalindurin.<br><br>5. Numri punonjësve të trajnuar. |
| 2. Të sigurohet që çdo institucion kujdesi shëndetësor për nënën dhe fëmijën, të ofrojë kujdes efektiv dhe bashkëkohor | 2.1 Nxitja e gjithë shërbimeve të maternitetit në vend që të promovojnë praktikat më të mira të Iniciativës “Spitale Mike të fëmijës” të OBSH/UNICEF që përputhen me 10 hapat e ushqyerjes me gji. | MSH, ISHP | Në vazhdimësi 2012-2015 | Viti 2012 - 0.72<br>Viti 2013- 0. 84<br>Viti 2014- 0.82 | 1.Numri institucioneve shëndetësore të akredituar për menaxhimin e ushqyerjes me gji. |

| OBJEKTIVAT | MASAT | INSTITUCIONET PËRGJEGJËSE/ BASHKËPUNUES | AFATI | BURIMET E ZBATIMIT (Million lek) | TREGUESIT |
|---|---|---|---|---|---|
| për ushqyerjen me gji duke zbatuar 10 hapat për një ushqyerje të suksesshme me gji. | 2.2 Trajnimi i punonjësve të kujdesit shëndetësor të përfshirë në programet shëndetësore për nënën dhe fëmijën lidhur me praktikat e ushqyerjes se suksesshme me gji.<br><br>2.3 Përfshirja e treguesve të ushqyerjes me gji në sistemin e monitorimit dhe vlerësimit të punës së institucioneve të kujdesit shëndetësor për nënën dhe fëmijën.<br><br>2.4 Kryerja e fushatave promocionale në media për të paraqitur ushqyerjen e shëndetshme me gji. | | | | 2. Numri i personelit shëndetësor të trajnuar për ushqyerjen me gji dhe çështjet gjinore lidhur me të.<br><br>3. Treguesit e ushqyerjes me gji të përcaktuar dhe të agreguar sipas gjinisë, vendndodhjes dhe gjendjes social ekonomike dhe të mbledhur periodikisht.<br><br>4. Numri fushatave në media lidhur me ushqyerjen me gji. |
| **Objektivi Strategjik 2. *Parandalimi i kequshqyerjes, obezitetit dhe mbipeshës tek fëmijët*** | | | | | |
| 1. Zbatimi i programeve kombëtare për të promovuar të ushqyerit e shëndetshëm, aktivitetin fizik të fëmijëve, "gender sensitive". | 1.1.Përcaktimi i udhëzuesve për ushqyerjen e foshnjave dhe fëmijëve.<br><br>1.2 Përgatitja e protokolleve të unifikuara për ndjekjen e rregullt të rritjes dhe zhvillimit të fëmijëve nga personeli i kujdesit shëndetësor parësor. | MSH | 2012-2015 | Brenda buxhetit të miratur për çdo institucion | 1. Udhëzuesit dietetikë për fëmijët të përgatitur sipas moshës dhe gjinisë.<br><br>2. Protokollet e hartuara.<br><br>3. Numri i treguesve lidhur me ushqyerjen e fëmijës të përfshira në sistemin e monitorimit të performancës së qëndrave shëndetësore. |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | 1.3 Përfshirja e treguesve lidhur me ushqyerjen e fëmijës në sistemin e monitorimit të performancës së qendrave shëndetësore.<br><br>1.4 Përfshirja në kurrikulat shkollore të edukimit, informacion mbi ushqyerjen e shëndetshme të fëmijëve.<br><br>1.5 Fushata IEK, (informimi edukimi komunikimi) në shkolla dhe media për rritje e aktivitetit fizik dhe ushqyerjen e shëndetshme tek fëmijët/adoleshentet. | ISHP, MASH | 2012-2015 | | 4. Numri i personelit shëndetësor të trajnuar për ushqyerjen dhe këshillimin për ushqyerjen.<br><br>5. Numri i trajnimeve të kryera.<br><br>6.Kurrikulat shkollore për ushqyerjen të përgatitura dhe të përfshira në programet shkollore.<br><br>7.Përqindja e personelit arsimor të trajnuar për rëndësinë e ushqyerjes dhe aktivitetit fizik.<br><br>8.Numri fushatave promocionale lidhur me aktivitetin fizik për fëmijët. |
| **Objektivi Strategjik 3.** ***Parandalimi i sëmundjeve ngjitëse dhe reduktimi i nivelit të sëmundjeve kryesore të fëmijërisë*** | | | | | |
| 1.Vaksinimi i plotë në kohë të gjithë fëmijëve sipas kalendarit kombëtar të vaksinimit. Monitorimi i cilësisë së vaksinave dhe survejimi për imunizim të popullatës. | 1.1 Rritja e mbulesës vaksinale tek fëmijët.<br><br>1.2 Zgjerimi i skemës së kalendarit të vaksinimit nëpërmjet futjes së vaksinave të reja.<br><br>1.3 Përfshirja në kalendarin e vaksinimit të grupeve të margjinalizuara, (p.sh popullata rome). | MSH, ISHP, | Në vazhdimësi 2012-2014 | Vaksinimi i fëmi-jëve<br>Viti 2012- 0.25<br>Viti 2013- 0.3<br>Viti 2014- 0.35 | 1.Përqindja e fëmijëve të vaksinuar sipas kalendarit rutinë.<br><br>2.Numri vaksinave te reja te përfshira në kalendarin kombëtar të vaksinimit.<br><br>3. Përqindja e popullatës rome të vaksinuar sipas kalendarit rutinë. |

| OBJEKTIVAT | MASAT | INSTITUCIONET PËRGJEGJËSE/ BASHKËPUNUES | AFATI | BURIMET E ZBATIMIT (Million lek) | TREGUESIT |
|---|---|---|---|---|---|
| | 1.4 Përmirësimi dhe unifikimi i sistemit të regjistrimit të vaksinave të fëmijëve. | | | | 4. Numri i personelit shëndetësor të trajnuar lidhur me imunizimin, dhe sistemin e raportimit. |
| | 1.5 Përmirësimi i vazhdueshëm i sistemit të zinxhirit ftohës dhe trainimi i personelit përkatës për ruajtjen sa më efektive të vaksinave. | | | Pajisje, laboratorë, teknologji te reja, mjedise te DSHP<br>Viti 2012- 0.1<br>Viti 2013- 0.1<br>Viti 2014- 0.1 | 5. Numri i personelit shëndetësor të trajnuar për zinxhirin ftohës. |
| | 1.6 Kontrolle periodike të situatave epidemiologjike për sëmundjet infektive dhe joinfektive. | | | Kontrollet e situatave epide-miologjike per se-mundjet infektive dhe jo infektive<br>Viti 2012- 2,3<br>Viti 2013- 2,2<br>Viti 2014- 2,3 | 6. Numri i kontro-lleve të bëra për sëmundjet infektive dhe joinfektive. |
| | 1.7 Fushata IEK në shkolla dhe komunitet për vaksinimin, parandalimin e sëmundjeve infektive. | ISHP, MASH | | | 7. Numri i aktiviteteve promo-cionale, edukimi shëndetësor i komu-nitetit, familjeve, lidhur me rëndësinë e vaksinimit të fëmijës.<br>Fuqizimi i sistemit ALERT.<br>8. Numri i aktiviteteve promocionale dhe edukuese për parandalimin e së-mundjeve infektive/ higjena ushqimore, vetjake dhe e ambjentit, masat mbrojtëse ndaj sëmundjeve ngjitëse, etj .<br>9. Numri i temave/orëve mësimore të zhvilluara në shkollë mbi sëmundjet infektive. |
| | 1.8 Ngritja e Observatorit të shëndetit në ISHP. | | | | 10.Observatori i shëndetit në ISH |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 2.Monitorimi i rregullt i rritjes dhe zhvillimit të fëmijëve 0-5 vjeç nga personeli i kujdesit shëndetësor parësor në qendrat shëndetësore dhe këshillimoret e fëmijës. | 2.1 Përcaktimi protokolleve të unifkuara, rregulloreve, etj për monitorimin e rregullt të rritjes dhe zhvillimit të fëmijës.<br><br>2.2 Trajnimi i personelit shëndetësor lidhur me monitorimin e rritjes, zhvillimit si dhe përmirësimin e aftësive këshilluese lidhur me shëndetin e fëmijës. | MSH, ISKSH | Në vazhdimësi | Buxheti i shtetit | 1. Protokollet e unifikuara, rregulloreve, etj për monitorimin e rregullt të rritjes dhe zhvillimit të fëmijës<br><br>2.Numri i qendrave shëndetësore që ofrojnë ndjekjen e rritjes dhe zhvillimit të fëmijës.<br><br>3. Përqindja e fëmijëve të moshës 0-1 vjeç që marrin vizitat e detyrueshme sipas protokollit klinik.<br><br>4.Numri i trajnimeve dhe personellit të trajnuar. |
| 3. Zgjerimi i modelit të MISF (Menaxhimi i Integruar i Sëmundjeve të Fëmijërisë) për ndjekjen dhe trajtimin e fëmijëve 0-5 vjeç në të gjitha shërbimet e KSHP të kujdesit për fëmijën. | 3.1 Trajnimi i personelit të KSHP mbi MISF.<br><br>3.2 Zgjerimi MISF në komunitetet me status të ulët social ekonomik. | MSH, ISHP | Në vazhdimësi | Brenda buxhetit të miratuar për çdo institucion | 1. Numri personelit te trajnuar.<br><br>2. Numri i komunave që janë përfshirë në modelin e MISF komunitar. |
| **Objektivi Strategjik 4. *Kontrolli dhe parandalimi HIV/AIDS dhe IST*** | | | | | |
| 1. Parandalimi dhe ulja e rasteve të HIV/AIDS dhe IST te fëmijët. | 1.1.Përcaktimi dhe ngritja e qendrave të referencës nëpër maternitete për parandalimin e transmetimit të HIV/AIDS nga nëna te fëmija. | MSH, ISHP | 2013 | Brenda buxhetit të miratuar për çdo institucion | 1. Numri i fëmijëve dhe nënave me HIV/AIDS.<br><br>2. Numri qendrave të referencës nëpër maternitete dhe që janë të pajisuara me reagentë dhe pajisje laboratorike për HIV/AIDS. |

| OBJEKTIVAT | MASAT | INSTITUCIONET PËRGJEGJËSE/ BASHKËPUNUES | AFATI | BURIMET E ZBATIMIT (Million lek) | TREGUESIT |
|---|---|---|---|---|---|
| | 1.2 Sigurimi i barnave antiretrovirale për PTNF (parandalimi transmetimit nënë-fëmijë) dhe për trajtimin e fëmijëve me HIV/AIDS.<br><br>1.3 Ngritja e një Qendre të specializuar për ndjekjen dhe trajtimin e fëmijëve me HIV/AIDS.<br><br>1.4 Përfshirja e informacionit mbi HIV/AIDS në programin shkollor.<br><br>1.5 Fushata IEK për parandalimin dhe përhapjen e HIV/AIDS në moshën fëminore dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve që vuajnë me HIV/AIDS për mosdiskriminimin e tyre nga shoqëria. | MASH, ISHP | 2012-2015 | | 3. Numri qendrave shëndetësore që ofrojnë trajtim për HIV/AIDS.<br><br>4. Numri i materialeve informative për HIV/AIDS të përgatitura dhe shpërndara.<br><br>5.Ofrimi i egzaminimeve dhe trajtimi i fëmijëve që vuajnë me HIV/AIDS, në një qendër të specializuar.<br><br>6. Numri i fushatave për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve që vuajnë me HIV/ AIDS. |
| **E drejta për Mbrojtje Ligjore** | | | | | |
| **Objektivi Strategjik 1. *Mbrotja e fëmijëve në konflikt me ligjin*** | | | | | |
| 1. Rritja e efikasitetit të procedimeve ligjore ndaj të miturve si dhe shkurtimi i afateve kohorë të tyre. | 1.1. Përmirësimi i aksesit në drejtësi nëpërmjet krijimit të seksioneve të të miturve në të gjithë gjykatat e shkallës së parë.<br><br>1.2. Rregullimet me kodin e procedurës penale që reflektojnë dënimin me burgim për të miturit si masë e fundit dhe për kohën më të shkurtër. | MD, UNICEF Organizata Ndërkombëtare<br><br>MD | 2013-2015<br><br>2013 | Sipas buxhetit të miratuar, donatorët | 1. Ulja e kohëzgjatjes së mbajtjes në paraburgim të të miturve (vlerësohet: 5-7 muaj, synimi : 2-4 muaj).<br><br>2. Dekreti i Presidentit për seksionet e të miturve në gjykatat e shkallës së parë. |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | 1.3. Trainimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve për të mitur me praktikat më të mira në administrimin e drejtësisë për të mitur.<br><br>1.4. Krijimi i dhomës së gjyqtarëve për të mitur. | MD, Shkolla e Magjistraturës, UNICEF<br><br>MD, ZABGJ | 2012-2015 | UNICEF – 40,000USD | 3.Miratimi i ndryshimeve në Kodin e Procedurës Penale.<br><br>4. Numri i trajnimeve dhe i të trajnuarve |
| 2.Rritja e përdorimit të masave alternative të dënimit me burgim dhe efikasitetit të ekzekutimit të vendimeve penale për të mitur. | 2.1 Vënia në eficience e zbatimit të dënimeve alternative për te miturit në të gjithë territorin nëpërmjet forcimit të shërbimit të provës.<br><br>2.2 Aplikimi i praktikave më të mira në zbatimin e dënimeve alternative për të miturit.<br><br>2.3 Zgjerimi i zbatimi i praktikave të drejtësisë restauruese dhe ndërmjetësismit për të miturit dhe krijimi dhomës së ndërmjetësve. | MD<br>UNICEF | 2013-2015<br><br>2012 | UNICEF – 240,000USD<br>Buxheti i shtetit<br>UNICEF – 120,000 | 1. Përqindja e të miturve në konflikt me ligjin të devijuar nga procesi gjyqësor dhe referuar në masa alternative të dënimit me burgim (vlerësim: 20%, synimi: 40%)<br><br>2. Protokolle, rregullore për zbatimin e dënimeve alternative për të miturit.<br><br>3. Krijimi i dhomës së ndërmjetësve. |
| 3. Rehabilitimi dhe rintegrimi i fëmijëve në konflikt me ligjin. | 3.1 Krijimi i dy institucioneve të Ekzekutimit të Vendimeve Penale për të Mitur (sipas modelit të Institutit të Kavajës), si dhe përmirësimi i gjendjes së seksioneve të të miturve në paraburgime.<br><br>3.2 Vendosja e treguesve të matshëm për vlerësimin e cilësisë së shërbimeve në I.E.V.P për të mitur.<br><br>3.3 Garantimi i arsimimit të detyrueshëm dhe shkollimi i fëmijëve në paraburgim dhe në burgje. | MD<br>MASH<br>UNICEF | 2015<br><br>2014-2015<br><br>Në vazhdimësi | | 1. % e të miturve në institucio-net e paraburgimit dhe vuajtjes së dënimit, që ndjekin arsim të detyruar (vlerësim: ska, synimi: 100% e të miturve që nuk kanë kryer arsimimin e detyruar ndjekin shkollën).<br>2. % e të miturve që kryejnë programe formimi profesional dhe programe rintegrues (vlerësim:50%, synimi: 90% kryejnë programe formimi profesional dhe programe rintegrues). |

| OBJEKTIVAT | MASAT | INSTITUCIONET PËRGJEGJËSE/ BASHKËPUNUES | AFATI | BURIMET E ZBATIMIT (Million lek) | TREGUESIT |
|---|---|---|---|---|---|
| | 3.4 Zbatimi i programeve riintegruese për të miturit e dënuar dhe paraburgim. | | | | 3. Treguesit për vlerësimin e cilësisë së shërbimit të miratuara. |
| **Objektivi Strategjik 2.** ***Sigurimi i mbrojtjes së duhur për fëmijët nën moshën 14 vjeç në konflikt me ligjin.*** | | | | | |
| 1. Plotësimi i kuadrit ligjor për fëmijët në konflikt me ligjin nën moshën (14 vjeç) e përgjegjësisë penale. | 1.1 Hartimi e një projekt ligji dhe akteve nënligjore për zbatimin e masave edukative për fëmijët nën moshën e përgjësisë penale.<br><br>1.2 Ngritja e shërbimeve të reja që kanë për qëllim ofrimin e shërbimeve të nevojshme, përkujdesjen e duhur psikologjike për fëmijët e kësaj kategorie. | MD,<br>NJQV,<br>OJF,<br>UNICEF<br>Organizata Ndërkombëtare | 2015 | Brenda buxhetit të miratuar, donatorët UNICEF – 120,000 | 1. Ligji i miratuar.<br><br>2. 50 % e të miturve që kryejnë krim dhe janë nën moshën e përgjëgjesisë penale të përfshirë në programe edukuese. |
| 2. Ndikim i drejtpërdrejtë në rehabilitimin e tyre në shoqëri. | 2.1 Vendosja e treguesve për matjen e rrezikut të përhapjes së aktiviteteve kriminale për fëmijët e kësaj kategorie. | MD<br>Drejtoria e Përgjithshme e Policisë | 2015 | | 1. Hartimi i një set treguesish. |

| **Objektivi Strategjik 3.** ***Mbrojtja e fëmijëve, viktima dhe dëshmitarë të krimit*** | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 1.Përmirësimi i kuadrit ligjor lidhur me mbrojtjen e fëmijëve viktima dhe dëshmitarë të krimit. | 1.1 Rregullimet në KPP dhe KP lidhur me trajtimin e të miturve si viktima dhe dëshmitarë të krimit.<br><br>1.2 Hartimi i protokolleve të trajtimit të të miturve si viktima dhe dëshmitarë. | MD, NJQV, OJF, UNICEF Organizata Ndërkombëtare | 2015 | Brenda buxhetit të miratuar, donatorët UNICEF – 120,000 | 1. Rregullimet në KPP, KP të miratuara.<br><br>2. Protokolle dhe sistemi i monitoirimit të trajtimit të miturve si viktima dhe dëshmitarë. |
| 2.Përmirësimi i trajtimit të të miturve si viktima dhe dëshmitarë. | 2.1 Përshtatja e ambjenteve të policisë ku intervistohen dhe mbahen të miturit, në mjedise miqësore për të miturit.<br><br>2.2 Trajnimi i Trajnerëve (gjykatës, prokurorë, polici gjyqësore, avokatë dhe punonjes socialë) për trajtimin e fëmijëve viktimave dhe dëshmitarëve të krimit.<br><br>2.3 Trajnimi vazhdues (Shkolla e Magjistraturës dhe Akdemia e Policisë) i profesionistëve të drejtësisë për të miturit për trajtimin e të miturve si viktima dhe dëshmitarë. | | | | 1. Ndryshime në infrastrukturën e mjediseve të policisë.<br><br>2. Numri i trajnimeve dhe i personave të trajnuar. |